

KOSOVA DHE SERBIA PAS MENDIMIT TË GJND-SË

Raport për Evropë nr 206 – 26 gusht 2010

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	i
I. HYRJE.....	1
II. KËNDVËSHTRIMET RRETH PROCESIT	3
A. KËNDVËSHTRIMI SERB	4
B. KËNDVËSHTRIMI KOSOVAR	5
C. KËNDVËSHTRIMI I NDËRKOMBËTARËVE	7
III. VERIU: TRI OPSIONE.....	9
A. PLANI I AHTISARIT DHE REALITETI I VERIUT	9
B. AUTONOMI MË E FUQISHME?	11
C. SHKËMBIM TERRITORESH?	13
1. Implikimet për rajonin	15
2. Implikimet për jugun.....	17
IV. ÇËSHTJET TJERA	19
A. KISHA ORTODOKSE SERBE.....	19
B. ÇËSHTJE TEKNIKE.....	21
1. Doganat dhe tregtia	21
2. Telekomunikimi	22
3. Energjia elektrike	22
4. Transporti	23
V. ALTERNATIVA PËR NJË MARRËVESHJE GJITHËPËRFSHIRËSE	24
A. NGRIJE VERIUN, SHKRIJI TË TJERAT	24
B. DËRGONI TRUPAT	25
VI. PËRFUNDIM.....	26
ANEKSET	
A. HARTA E KOSOVËS	28
B. FJALORTHI.....	29

KOSOVA DHE SERBIA PAS MENDIMIT TË GJND-SË

PERMBLEDHJA DHE REKOMANDIMET

Me dhënien e mendimit këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) mbi legalitetin e deklaratës së pavarësisë së Kosovës, në korrik të vitit 2010, Kosova dhe Serbia kanë mundësinë t'i tejkalojnë dallimet, të vendosin marrdhënie dypalëshe dhe të zhblllokojnë rrugën e tyre drejt integritimit në Bashkësinë Evropiane (BE). Pengesat janë të mëdha, duke përfshirë dyshimin e ndërsjellë, agjenda të kundërta dhe pasiguritë në lidhje me qëllimet e vërteta të secilës palë. Mosfillimi i bisedimeve në muajt e ardhshëm do të krijonte një konflikt të ngrirë për disa vite, pasi që palët do të hyjnë në procesin e zgjedhjeve gjatë të cilave situata e krijuar do të shfrytëzohej për mobilizimin e mendimit nationalist dhe largimin e vëmendjes nga kritikën rreth korrupsionit dhe dështimeve të qeverisë. Ndryshimet e kohëve të fundit në qëndrimet publike të Beogradit dhe Prishtinës, edhe pse jo gjithnjë publike, na bëjnë me dije se një zgjidhje e pranueshme për të dyja palët është e mundshme.

Në rrethana të pakushtëzuara dhe të mbikëqyrura nga BE-ja, Kosova dhe Serbia do të duhej që menjëherë të fillojnë bisedimet me qëllim të arritjes së një kompromisi gjithëpërfshirës. Draft-rezoluta e deponuar nga Serbia me 28 korrik, që bën thirrje për bisedime të reja për Kosovën, pritet të diskutohet nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së në muajin shtator. Kosova do të pranonte një dialog i cili nuk do të vinte në dyshim statusin dhe integritetin territorial të saj. Organizimi i një raundi të ri Kosovë-Serbi është sfidë e radhës për BE-në e ndarë, ku prej 27 anëtarëve, 22 e kanë njohur Kosovën ndërsa pesë nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Edhe këshilltarët e këtyre shteteve janë të ndarë në dy grupe: ata që mbështesin një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe të tjerët që thonë se vetëm qasja graduale, e filluar me çështje teknike është e realizueshme.

Çështja e njohjes diplomatike të shtetësisë së Kosovës është thelbi i problemit. Edhe pse 69 shtete kanë ndërmarrë një hap të tillë, Serbia është e vendosur mos ta njohë kurrë "deklaratën e njëanshme të pavarësisë" të territorit. Ky qëndrim, dhe frika që kanë nga precedentët secesionist janë argumentet që përdoren nga pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e njohin Kosovën. Në Këshillin e Sigurimit të KB-së, Rusia dhe Kina, si dhe

shumë anëtarë jo të përhershëm, kundërshtojnë njohjen. Prishtina shprejon që opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), do të nxisë më shumë njohje pasi që po kjo gjykatë konkludoi se deklarata e pavarësisë së Kosovës, e datës 17 shkurt 2008 nuk e kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare apo Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (baza legale për mbikëqyrjen e territorit nga OKB-ja, qysh nga fundi i luftës, më 1999). Megjithatë, qëndrimet e pesë shteteve anëtare të BE-së dhe të anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (sidomos Rusisë dhe Kinës), vështirë se do të mund të luhaten pa miratimin e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, së paku jopublikisht, përmes kanaleve diplomatike dhe eventualisht, me njohjen e plotë dhe formale.

Problemi i vërtetë në terren mbetet ai i komunave në veri të Kosovës. Veriu tash e dy dekada nuk është nën autoritetin e Prishtinës; popullata pakët dhe rurale serbe e kundërshton njëzëri integritetin në institucionet e Kosovës. Kundërshtimi përfshin edhe planin e Marti Ahtisaarit, ish-presidentit të Finlandës dhe laureatit të cmimit Nobel për paqe, i cili kishte hartuar këtë plan në cilësinë e të dërguarit të posaçëm të KB-së, më 2007, me të cilin rregullohet pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës, duke ofruar nivel të lartë të vetëqeverisjes për komunat me shumicë serbe dhe duke u dhënë kompetenca shtesë në fushën e edukimit dhe shëndetësisë. Serbia ende administron me komunat, gjykatat, policinë, doganat dhe shërbimet publike, ndërsa Misioni për Sundim të Ligjit i BE-së (EULEX) ka një prezencë të zbehur atje. Dy incidentet në Mitrovicë, që ndodhën në korrik, treguan se dhuna mbetet kërcënim real.

Ekzistojnë tri zgjidhje të arritshme për Veriun: plani i Ahtisaarit, autonomi e zgjeruar dhe shkëmbim terrioresh. Grupi i Krizave ka qenë ndër përkrahësit më të fuqishëm

të planit të Ahtisaarit në kohën e hartimit të tij. Megjithatë, deri më tani nuk ka mjaftuar vetëm ky plan për të integruar Veriun e vendit apo për rritjen e numrit të njohjeve ndërkombëtare të Kosovës. Prishtina do të mund të ofronte të drejta shtesë për Veriun, të drejta këto që mund të krahasohen me ato të rajoneve evropiane e ku do të përfshiheshin legjislatura dhe ekzekutivi rajonal, policia

dhe gjyqesia lokale, si dhe marrëveshja se pjesa më e madhe e taksave dhe pagesave të mbledhura atje do të takonin atij rajoni. Por, nuk ka shenja të qarta se Beogradi apo serbët e Veriut do të praninin as këtë autonomi të zgjeruar. Për më shumë, ndarja, sipas tyre, do të mund të krijonte një situatë të tillë ku Serbia do ta njihte pjesën tjetër të Kosovës si shtet të pavarur.

Prishtina nuk e pranon ndarjen por lë të kuptohet se mundësia e shkëmbimit të Veriut të banuar me serbë dhe pjesëve të Luginës së Preshevës të banuara me shqiptarë mund të konsiderohet si zgjidhje. Disa kosovarë shqetësohen në lidhje me autonominë e Veriut, por shumica e ndërkombëtarëve konsiderojnë se ndryshimi i kufijve do të nxiste zhvendosjen e serbëve që jetojnë në jug të Ibrit e poashtu do të rrezikonte stabilitetin e Maqedonisë fqinje dhe Bosnje e Hercegovinës. Grupi i Krizave, në të kaluarën ka tërhequr vërejtjen për një gjë të tillë, por hulumtimet më të reja tregojnë se këto shqetësime nuk janë më valide.

Një çështje ndoshta edhe më delikate sesa ajo e fatit të rreth 45,000 serbëve në Veri, është ajo e statusit dhe sigurisë së manastireve dhe kishave ortodokse serbe. Plani i Ahtisarit ofron mbrojtje të zgjeruar, por Kisha kërkon më shumë, kryesisht falë frikës se sulme të ngjashme me ato të marsit, 2004 mund të përsëriten. Asnjë udhëheqës në Serbi nuk do të mund ta mbante gjallë debatin mbi Kosovën pa mbështetjen e fuqishme të Kishës Ortodokse. Rrjedhimisht, Beogradi dëshiron ta forcojë pozicionin e Kishës duke fituar së paku premtimin për eksterritorialitetin, garancat për marrëveshjen eventuale dhe mbrojtjen e kishave dhe manastireve nga një forcë ndërkombëtare pas largimit të forcave paqeruajtëse të NATO-s (KFOR). Duket sikur ka hapësirë që qeveria në Prishtinë, e cila tashmë ka bërë lëshime të mëdha për Kishën gjatë bisedimeve të Ahtisarit, ta shqyrtojë edhe një herë këtë çështje, pa paragjykuar sovranitetin e saj.

Mirëpo, para se të shqyrtohen statusi, veriu i vendit apo kishat, Prishtina do të dëshironte që bisedimet të fokusoheshin në çështje teknike si doganat, tregtia, komunikimi, energjetika dhe transporti. BE-ja dhe SHBA-të gjithashtu preferojnë që të fillohet me çështje të tilla, më pak të ndjeshme, në mënyrë që të ndërtohet besimi i ndërsjellë. Po të njëjtat paraqesin probleme të cilat ndikojnë në jetën e përditshme të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, duke ua kufizuar qasjen në mallra dhe shërbime. Por, përpjekjet e deritanishme të BE-së, që me diplomaci levizëse ("shuttle diplomacy") të ndryshojnë gjendjen në terren kanë dështuar. Me gjasë, çështja e statusit do ta bllokonte progresin edhe në këto fusha, përpos nëse Beogradi tregon gatishmëri që ta njohë, së paku në mënyrë implicite autoritetin e Kosovës.

Në mënyrë që të ketë bisedime serioze, gjithëpërfshirëse e që do të sillnin një marrëveshje përfundimtare, dialogu

dypalësh duhet të tejkalojë suazat e çështjeve teknike. Nëse Serbia me të vërtetë kërkon progres thelbësor dhe dëshiron ti bindë BE-në dhe SHBA-në se është e vendosur të negociojë e jo vetëm të vonojë njohjet eventuale të Kosovës, atëherë ajo duhet ta njohë Kosovën si partner të barabartë, edhe nëse nuk e njeh si shtet të pavarur. Grupi i Krizave është optimist për këtë mundësi. Në qeverinë e Tadic-it sot ekziston mirëkuptim shumë më i gjithanshëm në lidhje me çështjen e Kosovës sesa që ka ekzistuar ndonjëherë në atë të Koshtunicës. E gjitha ka arritur në atë pikë sa disa zyrtarë janë në kërkim të metodave kreative që në mënyrë të ndershme ta lirojnë Serbinë nga barra e Kosovës. Qeveria insiston në aftësinë e saj për të mbajtur nën kontroll opinionin publik, por kërkon që ti krijohen mundësitë që të dalë faqebardhë para nacionalistëve dhe të mos shihet si tradhtare e interesave nacionale. Në anën tjetër, edhe Prishtina është bërë më realiste në lidhje me atë se çka ata dhe përkrahësit e tyre ndërkombëtar mund të bëjnë në veri të vendit.

Komuniteti ndërkombëtar do të duhej të hartonte rregulla të lojës sa më gjithëpërfshirëse, duke ua lënë palëve të vendosin se sa larg dhe në çfarë drejtimi mund të shkojnë për të arritur qëllimin e tyre. Rezultati më i paqartë që mund të dalë nga këto negociata, do të ishte ai i shkëmbimit të territoreve mes Veriut të Kosovës me serbë dhe pjesës etnike shqiptare të Luginës së Preshevës në Serbi. As Prishtina e as Beogradi nuk dalin haptazi me këtë propozim por zyrtarë të të dyja kqyeqyteteve kanë filluar të flasin për këtë opcion, në kontaktet me Grupin e Krizave. Në komunitetin ndërkombëtar, një numër i vogël do të ishin të lumtur me një zgjidhje të tillë. Grupi i Krizave mendon se asnjë opcion për marrëveshje nuk duhet të largohet nga tavolina e bisedimeve pasi që kjo do të mund të krijonte një konflikt të ngrirë, pa garanca për zgjidhje eventuale të tij. Autonomia e zgjeruar për Veriun, statusi autonom vetëqeverisës i Kishës Ortodokse Serbe, i paraparë me planin e Ahtisarit, në shkëmbim të njohjes së Kosovës nga Serbia do të ishte e pranueshme për të dyja palët. Por, as Prishtina e as Beogradi nuk janë të gatshëm të hyjnë në këtë proces, ndërsa komuniteti ndërkombëtar, edhe ashtu i përçarë, nuk është në pozitë për të ushtruar tryzni. Nëse edhe shkëmbimi i territoreve është i papranueshëm, ndërsa një zgjidhje gjithëpërfshirëse del të ketë qenë iluzion, një status i përkohshëm për Veriun mund të jetë zgjidhje që ia vlen të merret parasysh.

Në mënyrë që Brukseli ta konsiderojë pozitivisht aplikacionin e Serbisë për kandidat në BE, Serbia duhet të jetë e vendosur të bashkëpunojë me Prishtinën për vendosjen e rendit dhe ligjit në veri, marrëdhënie të mira fqinjësore si dhe për një mori çështjesh teknike me qëllim të përmirësimit të jetës së përditshme për popullatën.

Serbia gjithashtu duhet ti ndalë përpjekjet e saja për të penguar pjesëmarrjen e Kosovës në institucionet rajonale. Nëqoftëse bisedimet dështojnë tërësisht, BE-ja dhe SHBA-

të mund të provojnë ta integrojnë Veriun me shtrirjen e EULEX-it dhe të forcave të rendit të Kosovës në atë pjesë të vendit. Megjithatë, numri i reduktuar i trupave ushtarake, resurset e pakta dhe ndikimi i vogël politik në atë pjesë e bën këtë opcion gati të pamundshëm.

REKOMANDIME

Për Bashkësinë Evropiane (BE), shtetet anëtare të BE-së dhe qeverinë e SHBA-së:

1. Të ofrojnë ndërmjetësimin në negociatat Kosovë-Serbi, në bazë të parimeve në vijim:
 - a) bisedimet do të mbaheshin në nivel të Boris Tadic-it për Serbinë dhe kryeministrit Hashim Thaçi për Kosovën;
 - b) bisedimet do të duhej të fillonin sa më shpejtë dhe të përfundonin në fillim të verës 2011; dhe
 - c) vetë palët do të duhej ta caktonin agjendën, pa përjashtuar asnjë temë qysh në fillim të bisedimeve.
2. Të caktojnë një diplomat të lartë për të filluar përgatitjet e bisedave, duke përfshirë edhe lëvizjen konstante mes Beogradit e Prishtinës.
3. Të japin premtimin se do të pranojnë çfarëdo marrëveshje të arritur mes dy palëve.
4. Të rifillojnë përpjekjet për arritjen e kompromisit rreth çështjes së emrit midis Greqisë e Maqedonisë si dhe të ruhet stabiliteti në Bosnje e Hercegovinë nga efektet e mundshme negative me rastin e fillimit të negociatave Kosovë-Serbi.
5. Të punohet me Kosovën që të arrihen më shumë njohje ndërkombëtare.

Për qeverinë e Kosovës dhe të Serbisë:

6. Të pranohet ndërmjetësimi dhe qasja në bisedime si palë të barabarta.
7. Të konsiderohet një zgjidhje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë këto elemente:
 - a) njohja e Kosovës me kufijtë ekzistues;
 - b) autonomi e zgjeruar për rajonin në veri të lumit Ibër në përputhje me integritetin territorial të Kosovës, duke përfshirë legjislativin dhe ekzekutivin rajonal, kontrollin mbi pjesën më të madhe të taksave dhe çështje tjera për të cilat do të ketë mirëputim të dyanshëm; dhe,
 - c) status vetëqeverisës autonom për mjediset e Kishës Ortodokse Serbe, duke përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të planit të Ahtisarit, të cilave do t'i shtohet sigurimi i armatosur ndërkombëtar pas

largimit të KFOR-it dhe të garantuar me një marrëveshje apo rezolutë të Këshillit të Sigurimit.

8. Nëse zgjidhja gjithëpërfshirëse nuk arrihet, përkrahni njëri tjetrin në zbatimin e rendit dhe ligjit në Veri dhe vendosni marrëdhënie të mira fqinjësore duke përmbyllur marrëveshje në fushën e tregtisë, doganave, komunikimit, energjetikës dhe transportit, të cilat do t'ua lehtësonin jetën qytetarëve dhe njëkohësisht do ta forconin ekonominë e Kosovës dhe atë të Serbisë.
9. Të hapen me procedurë të shpejtë zyra përfaqësuese pa akreditim ambasadorial në Prishtinë dhe Beograd.
10. Të bashkëpunohet për të mundësuar sigurinë dhe funksionimin e zyrës së Kosovës në Mitrovicën Veriore.

Për Qeverinë e Serbisë:

11. Të ndërtohet besimi i ndërsjellë duke lejuar pa vonesa të mëtejme pjesëmarrjen e Kosovës, pa KB-në, në organizata ndërkombëtare të cilat nuk prejudikojnë statusin e Kosovës. Organizata të tilla mund të jenë Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve, CEFTA dhe institucione rajonale të zbatimit të ligjit.
12. Të punohet me shtetet anëtare për amendamentimin e Rezolutës së propozuar për Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të KB-së me qëllim të krijimit të ambientit për dialog dhe për të fituar përkrahje sa më të gjërë.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 26 gusht, 2010

KOSOVA DHE SERBIA PAS MENDIMIT TË GJND-SË

I. HYRJE

Ndarja e Kosovës nga Serbia, në shkurt të vitit 2008, i dha fund shumicës së kontakteve mes dy qeverive dhe e zhvendosi mosmarrëveshjen mes tyre në fushën e së drejtës dhe diplomacisë ndërkombëtare, ku edhe u zhvillua beteja – si drejtpërdrejt ashtu edhe përmes personaliteteve të autorizuar.¹ Të dyja palët morën qëndrime të ngurta nga frika se çfarëdo ndryshimi do t'ua dobësonte pozitën në betejën legale. Mendimi këshillëdhënës i dhënë më 22 korrik, 2010 nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) i dha fund kësaj faze. Kosova dhe Serbia tashmë janë të lira të flasin drejtpërdrejt me njëra tjetrën, kurse Bashkimi Evropian (BE) ka ofruar ndërmjetësim.

Me dhjetë vota për dhe katër kundër, GJND-ja konstatoi se deklarata e pavarësisë së Kosovës “nuk e ka shkelur ligjin e pergjithshëm ndërkombëtar, Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999) apo Kornizën Kushtetuese” të instaluar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).² Ky ishte një verdikt i ngushtë; gjykata vetëm konkludoi se nuk ekzistonin ndalesa për shpalljen e pavarësisë, e jo se Kosova kishte leje për të bere një gjë të tillë apo se kishte “te drejtën për tu shkëputur nga shteti”.³ Një numër gjyqtarësh menduan se mendimi i gjykatës to të duhej të shkonte edhe më tej, duke prekur çështjen e së drejtës për “ndarje shëruese” si pasojë e abuzimeve

drastike të të drejtave të njeriut; në momente të caktuara gjyqtarët drejtuan gishtin kah implikimet më të gjera për “te drejtën për pavarësi për popujt e territoreve pa vetë-qeverisje dhe popujve që i janë ekspozuar nënshtrimit të huaj, dominimit dhe eksploatimit”.⁴

Mendimi këshillëdhënës i GJND-së ishte disfatë për Serbinë por jo edhe fitore për Kosovën. Ai i dha fund shpresës së Beogradit për të shfrytëzuar GJND-në si pikënisje për rihapjen e bisedave mbi statusin e Kosovës dhe kjo rrit edhe më shumë gjasat që Beogradi të pranojë të fillojë bisedat me udheheqësit e Kosovës, si partnerë të barabartë. Në përpjekje për ta marrë veten pas iniciativës në GJND, Beogradi u armiqësua edhe më shumë me shtetet e BE-së kur më 28 korrik, në kuadër të reagimit ndaj mendimit të GJND-së, propozoi në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara një projekt-rezolutë e cila nuk qe koordinuar paraprakisht me Brukselin. Mendimi i GJND-së nuk i bindi shtetet kritike ndaj pavarësisë dhe ato të pavendosura që ta njohin të drejtën e Kosovës për pavarësi. Asnjë nga pesë shtetet anëtare të BE-së nuk ka dhënë shenja për ndërrim të kursit politik, kështu që Brukseli nuk do mund të marrë një qëndrim të qartë rreth statusit të Kosovës. Në anën tjetër, edhe sikur Kosova të arrinte shumicën në Asamblenë e Përgjithshme, Kina dhe Rusia do të vazhdonin bllokimin e anëtarësimit të Kosovës në Kombet e Bashkuara. Pritjet se pas mendimit të GJND-së do të vinin shumë njohje në adresë të Kosovës janë treguar të pasakta, ndërsa ka pak shenja që do të tregonin se miqtë e Kosovës janë duke u përpjekur që ti bindin tjerët për ta njohur Kosovën si shtet sovran.⁵

Në Prishtinë, vendimi i GJND-së ka ndihmuar në zvogëlimin e frustrimit të prodhuar nga procesi i ngadalshëm i

¹ Në vitin 2008, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka kërkuar nga GJND-ja të japë një opinion këshillëdhënës në pyetjen, “A është deklarimi unilateral i pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare”. “Kërkesë për një opinion këshillëdhënës nga Gjyqi Ndërkombëtar i Drejtësisë rreth legjitimitetit ndërkombëtar të shpalljes të njëanshme të pavarësisë nga Kosova”. UNGA A/RES/63/3, 8 tetor 2008. Ministri i Jashtëm i Serbisë, Vuk Jeremic, pohoi se opinioni i GJND-së “do të jetë udhërrëfyes politikisht neutral por me peshë legale”; SHBA-ja dhe disa qeveri tjera të cilat njohin Kosovën kanë thënë se nuk do ta ndryshojnë politikën e tyre edhe pas opinionit. Mbledhja e 22-të plenare e Asamblesë së përgjithshme, A/63/PV.22, 8 tetor, 2008.

² *Pajtimi me te Drejtën Ndërkombëtare të Deklaratës së njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën, Mendim Këshillëdhënës*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, 22 korrik, 2010 (më tej “Mendimi Këshillëdhënës”), fq. 43, para. 122.

³ Ibid, fq. 31, para. 83. Gjykata nuk e ka adresuar çështjen e vetëvendosjes apo të drejtën për secession.

⁴ Ibid, fq.30, para. 79; Shih deklaratën e gjykatësit Simma, që bën thirrje për “përgjigje më gjithëpërfshirëse” dhe kritikon “qasjen [në të cilën] cdo gjë që nuk është e ndaluar haptazi bart me vete të njëjtën ngjyrë të legalitetit; nuk merr parasysh nivelet e mundshme të jo-ndalueshmërisë, duke u nisur prej “e tolerueshme” në “e lejueshme” e deri në “e dëshirueshme””. Shih poashtu Mendim i vecantë i gjykatësit Cancado Trindade.

⁵ Zyrtarë të lartë të një shteti fqinj i kanë thënë Grupit të Krizave se presin numër të “kufizuar” njohjesh pas shtatorit, 2010 dhe kanë vlerësuar se Kosova ka humbur nga fakti se shihet si projekt i SHBA-së nga shume shtete arabe e aziatike; Intervistat e Grupit të Krizave, 27-28 korrik, 2010.

njohjeve dhe nga qasja neutrale ndaj statusit e pëlqyer nga KB-të dhe BE-ja. Për shqiptarët e Kosovës, plani i Ahtisaari ka qenë një pilulë e thartë të cilën është dashur ta përbijnë për të fituar mbështetjen ndërkombëtare për pavarësinë.⁶ Sikurse shumë popuj tjerë të ish-Jugosllavisë, shqiptarët kanë pasur luftë të ashpër me forcat serbe. Për ndryshim prej të tjerëve, pas luftës, republika e tyre kaloi tetë vite të administrimit jo edhe aq cilësor të Kombeve të Bashkuara, periudhë kjo që përfundoi me fillimin e procesit negociator.⁷ Kosova ishte shtyrë të pranojë një kushtetutë të shkruar kryesisht nga të huajt, ku përfshihen ndalimi i bashkimit me Shqipërinë, mosekzistimi i ushtrisë si dhe të drejta shumë më të mëdha për minoritetin serb në krahasim me të drejtat të cilat i kanë minoritetet tjera në Ballkan. Pavarësia e Kosovës do të jetë e “mbikëqyrur” për një kohë të pacaktuar nga zyrtarët ndërkombëtarë.⁸ Në vend të shqiptonjës së zezë dykrenare në sfond të kuq, shqiptarëve të Kosovës u është prezentuar flamuri i dizajnuar nga ndërkombëtarët, me tri ngjyra, të kaltër, bardhë e të verdhë, flamur ky kombëtar i dashur për askend.

Megjithatë, Kosova ka shënuar përparim të dukshëm në vitet e para të pavarësisë. Ajo ka një qeveri funksionale, është duke ndërmarrë hapa në forcimin e sundimit të ligjit⁹ dhe është në pozitë më të mirë për biseda se sa që ishte në vitet 2006-2007. Kosova është njohur nga 69 shtete, duke përfshirë 22 nga BE-ja dhe dy të tretat e Këshillit të Evropës. Edhe disa shtete që nuk e kane bërë një gjë të tillë, jozyrtarisht pranojnë se pavarësia dhe shtetësia e Kosovës janë fakte që nuk mund të zhbëhen.¹⁰

⁶ Shprehjet “plan” dhe “plani i Ahtisarit” përdoren në tekst për t’iu referuar skemës së plotë të përfshirë në Raportin e Ahtisarit dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (CSP), të lexuara së bashku. Këto ishin dokumentet e presidentit Ahtisari, emisar special i OKB-së, të dorëzuara tek Sekretari i Përgjithshëm në mars, 2007, i cili pastaj i dërgoi ato në Këshillin e Sigurimit me miratimin e tij të plotë.

⁷ Shih raportet për Evropë të Grupit të Krizave, numër 161, *Kosova: Drejt Statusit Final*, 24 janar, 2005; numër 177, *Statusi I Kosovës: Vonesa është e rrezikshme*, 10 nëntor, 2006; numër 182, *Kosova: Pa alternativa më të mira ndaj planit Ahtisari*, 14 maj, 2007; numër 185, *Dalja nga qorrsoaku i Kosovës: Përgjegjësi e Evropës*, 21 gusht, 2007; dhe numër 188, *Ditët e numëruara të Kosovës: Shenjë për Tranzicionin*, 6 dhjetor, 2007.

⁸ Bosna e Hercegovina poashtu është nën mbikëqyrjen ndërkombëtare por nuk i është kërkuar ta pranojë ate si kusht për pavarësi; përkundrazi, komuniteti ndërkombëtar e krijoi ate në një moment kur institucionet e Bosnjes kishin pushuar së funksionuari gati tërësisht.

⁹ Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave, numër 204, *Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur*, 19 maj, 2010

¹⁰ Intervista të Grupit të Krizave, diplomatë dhe zyrtarë të vendeve mos-njohëse të BE-së, Beograd, 16 qershor, 2010; Bruksel, 23 qershor, 2010; zyrtarë të lartë të Sekretariatit të Këshillit të Evropës, Bruksel, 23 e 27 korrik, 2010.

Shumica e serbëve ndihen të mposhtur dhe të poshtëruar nga ngjarjet që kulminuan me pavarësinë e Kosovës dhe dëshirojnë rishqyrtimin e disa pjesëve të këtij procesi.¹¹ Përfaqësuesit e tyre në bisedime ankohen se negociatat për statusin, të ndërmjetësuara nga KB-të kishin filluar me pavarësinë si të vetmen zgjidhje.¹² Disa mendojnë se ky qëndrim vjen si pasojë e mosbesimit të ndjellë qysh nga koha e negociatave të Rambujesë, më 1999, ku sipas Beogradit, NATO-ja paraprakisht kishte vendosur të fillonte sulmet ajrore.

Pas pavarësisë së Kosovës, qeveria e kryeministrit Vojislav Koshtunica u shpërbë. Qeveria pasuese, e krijuar në maj 2008, la menjanë politikën e vjetër të shkëputjes së lidhjeve diplomatike me qeveritë që kishin njohur Kosovës. Në vend të saj, politika e re e Beogradit ishte në favor të një fushate diplomatike kundër njohjeve të reja, në pengimin e Kosovës për t’u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare si dhe në vënien në dyshim të pavarësisë pranë GJND-së. Qëllimi i fushatës ishte rikthimi i Kosovës në tavolinën e bisedimeve, duke bërë kështu me dije se vetëm Serbia mund ti japë Kosovës anëtarësimin në KB dhe legjitimitetin e plotë ndërkombëtar.

Njohja e ndërsjellë ende mbetet problemi kryesor. Kur udhëheqësit e Beogradit e Prishtinës ulen përfundimisht në një tavolinë, ata do të duhej të bisedonin për rrethanat në të cilat Serbia do ta njohte pavarësinë e Kosovës dhe në të cilat ajo do pajtohej me anëtarësimin e Kosovës në organizatat rajonale e ndërkombëtare. Kjo do të aktivizonte debatin për dy çështje tjera problematike, atë të manastireve dhe kishave ordokse serbe në Kosovë si dhe çështjen e Veriut të mbajtur nga serbët. Kosovës ende i duhet njohja nga Serbia: pa këtë njohje, Rusia dhe Kina nuk do të pranonin anëtarësimin e Kosovës në KB.¹³ Në anën tjetër, së paku tri nga pesë shtetet e BE-së që nuk e

¹¹ Intervistë e Grupit të Krizave, gazetar i njohur serb, Beograd, 15 qershor, 2010. Një zyrtar i lartë spanjoll i ka thënë Grupit të Krizave se “pozita jonë rreth Kosovës është tejet kontradiktore, duke qenë mes synimeve tona për forcimin e politikës së jashtme të BE-së në njërin anë dhe faktit se në kontribujmë në dobësimin e saj në vetë kontinentin evropian. Në qeveri secili është i vetëdijshëm për këtë kontradiktë por ne nuk mund ta ndërrojmë pozicionin tonë në këtë moment”, intervistë, Madrid, 25 shkurt, 2010.

¹² Kjo pikëpamje nuk është vetëm e Serbisë; intervistë e Grupit të Krizave, Një zyrtar i lartë i OKB-së i involvuar në bisedimet për statusin, 3 dhjetor, 2009. Bisedat e sponsorizuara nga OKB-ja, të udhëhequra nga Marti Ahtisari, ish-president i Finlandës, ndodhën më 2006, me raunde përcjellëse të mbajtura nën treshën e SHBA-së, BE-së dhe Rusisë, më 2007.

¹³ Asambleja e Përgjithshme mundi ti japë Kosovës statusin e shikuesit me shumicë votash, por anëtarësimi i plotë në OKB kërkon miratimin në Këshillin e Sigurimit, ku Moska dhe Pekini kanë të drejtën e vetos.

kanë njohur Kosovën¹⁴, janë në pritje të vendimit të Serbisë, duke bllokuar kështu perspektivën evropiane të Kosovës dhe duke i imponuar BE-së që të jetë neutrale ndaj statusit.¹⁵ Në të njëjtën kohë, është e vështirë të besohet se BE-ja do ta pranonte Serbinë, përderisa ajo nuk e njeh Kosovën. Por, në momentin kur Kosova dhe Serbia zgjidhin problemin e njohës së ndërsjellë, të tjerët duhet të pajtohen me këtë; pa marrë parasysh qëndrimet e tyre rreth pavarësisë, asnjë shtet nuk mund të insistojë se Kosova është pjesë e Serbisë nëse kjo e fundit vendos ta njohë Kosovën si të pavarur.

Në fillim ishte pritur që plani i baraspeshuar i Ahtisarit të miratohej edhe formalisht me një rezolutë të re të Këshillit të Sigurimit të KB-së e cila do ta zëvendësonte Rezolutën 1244 (1999), e cila kishte vendosur prezencën civile ndërkombëtare për administrimin e përkohshëm të Kosovës (UNMIK). Mirëpo, kjo nuk ndodhi dhe tani shqiptarët e Kosovës e shohin planin e Ahtisarit si të njëanshëm, ku ata i kryen obligimet e tyre komuniteti ndërkombëtarë nuk e mbajti premtimin e dhënë. Edhe pas dy vitesh, Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe ka sovranitet të kufizuar; UNMIK-u është ende aktiv edhe pse dukshëm i reduktuar, Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) operon kurse misioni për sundim të ligjit i BE-së (EULEX) është neutral ndaj statusit.

Opinionin këshillëdhënës i GJND-së nuk do të ndryshojë asnjëherë nga këto. Vetëm diplomacia do të mund ta bënte këtë. Njohja e ndërsjellë, trashëgimia ortodokse serbe e Veriu, si dhe bashkëpunimi teknik janë pikat kryesore në të cilat Kosova e Serbia duhet të punojnë për arritjen e një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse, me ndihmën e BE-së dhe SHBA-së. Mirëpo, edhe një zgjidhje e pjesërishtme, sipas të gjitha gjasave, do të mund të tejkalonte kufinj të planit të Ahtisarit, të pranuar nga Kosova dhe të integruar në kushtetutën dhe ligjet e vendit.¹⁶

II. KËNDVËSHTRIMET RRETH PROCESIT

Me përjashtim të takimeve të shkurtëra të rastit në takime të mëdha ndërkombëtare, udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë nuk kanë pasur kontakte të drejtpërdrejta qysh nga shkurti i vitit 2008. Para se të fillojë çfarëdo procesi i bisedimeve, që të dyja palët janë kujdesur që të fshehin strategjitë e tyre negociuese dhe janë paraqitur me qëndrime të ashpra në publik, duke i zhvleftësuar propozimet e palës tjetër dhe duke ekzagjeruar pasojat e dhimbshme që bartin koncesionet. Komunikimi i Serbisë me SHBA-në dhe BE-në përcillet me dyshime të ndërsjella. Kosova ka mbështetje më të madhe nga këto qendra por besohet se nuk ka strategji të definuar.

Si Serbia ashtu edhe Kosova ndihen të pambrojtura. Duke qenë të përjashtuar nga takimet ndërkombëtare dhe shpesh të shtyrë të marrin pjesë nën ombrellën e UNMIK-ut, zyrtarët kosovarë, relativisht të papërvojë ndihen më inferiorë kundrejt politikës së jashtme serbe e cila ka një përvojë të gjatë. Kjo ndjenjë bëhet më e madhe nga pamundësia e Prishtinës që të kontrollojë Veriun e vendit. Në anën tjetër, Serbia frikësohet nga kampanja pro Kosovës e udhëhequr nga SHBA-të dhe mundohet të gjejë miq jashtë OKB-së, organ ky tradicionalisht mikpritës. Zyrtarisht, që të dyja palët mundohen t'i fshehin qëllimet e tyre të vërteta: Kosova thotë se nuk i nevojitet një anëtarësim i shpejtë në OKB, kurse Serbia thotë se për anëtarësim në BE duhet kohë e gjatë, prandaj nuk është çështje e rëndësishme për momentin.

Megjithatë, tashmë që të dyja palët kanë deklaruar se janë të gatshme të bisedojnë në një proces të mundësuar nga ndërkombëtarët. Ndërkaq qëndrimet publike lidhur me atë se çka mund të marrin nga njëri-tjetri janë shumë më reale si në Prishtinë ashtu edhe në Bograd. Presidenti Tadiç dhe kryeministri Thaçi kanë përfituar nga fakti se që të dy kanë shumicën dërmuese në parlament dhe për-krahje të fortë popullore. Është në interesin e tyre t'i mënjanojnë pengesat që i kanë për integrim në Evropë, gjë që do tu jepte një pamje tjetër jashtë vendeve të tyre. Në ndërkohë, BE-ja është në kërkim të ndonjë suksesi sa më të shpejtë në mënyrë që t'i zbusë kritikën që vijnë në adresë të saj në lidhje me makinerinë e re të politikës së jashtme (Shërbimi i Aksionit Evropian) si dhe rreth joefikasitetit të saj në politikën e jashtme për shkak të preokupimeve për ndryshimet institucionale. Përderisa BE-ja, Beogradi dhe Prishtina janë duke folur për bisedime, ende mbetet shumë për t'u qartësuar sa i përket modaliteteve, kohës dhe parametrave.¹⁷

¹⁴ Kosova nuk është njohur nga Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

¹⁵ Vendimi i GJND-së është shqetësues për Qipronë, dhe në një shkallë më të ulët për Sllovakinë dhe Rumaninë, shtete këto të cilat kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës për shkak të brengave në lighje me ndarjet e mundshme (apo në rastin e Qipros, ndarjen ekzistuese).

¹⁶ Sic thuhet në mendimin e GJND-së, deklarata e pavarësisë së Kosovës e obligon atë që "pakthyeshem... të punojë në përputhshmëri me provizionet e hartuara në këtë deklaratë duke përfshirë obligimet që dalin nga plani i Ahtisarit"; Mendimi Këshillëdhënës, fq. 29, para. 75.

¹⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Bruksel, 6 gusht, 2010.

A. KËNDVËSHTRIMI SERB

Pozicioni i Beogradit mbështetet në dy elementë: mosnjohja e pavarësisë së Kosovës, të cilën serbët e quajnë “DNP” (deklarata e njëanshme e pavarësisë), dhe arritja e një kompromisi pa fitues apo humbës absolut. Që të dyja qëndrimet janë të lidhura ngusht me *procesin* që çoi drejt pavarësisë. Retorika se kurrë nuk do të pranohet pavarësia e njëanshme e Kosovës, në mediat e Prishtinës dhe ato përfundimtare konsiderohet si refuzim për t’u ballafaquar me realitetin. Por ky interpretim nuk arrin të vërejë ndryshimin e butë të fjalëve. Përderisa dikur, udhëheqësit e Serbisë thonin se kurrë nuk do ta njihnin Kosovën qoftë në mënyrë “direkte apo indirekte”, ata tani thonë se nuk do ta njohin deklaratën e njëanshme të pavarësisë apo “DNP-në”.¹⁸ Njohja e pavarësisë tanimë është në tavolinë. Sipas një zyrtari të lartë në Beograd, ata që e konsiderojnë njohjen e Kosovës tradhti kanë një mision të pamundshëm të shpjegojnë se “si të integrohen në vendin tone dy milion njerëz të cilët na urrejnë”.¹⁹

Strategjia e qeverisë serbe ishte bazuar në marrjen e mendimit të GJND-së i cili do të mund të përdorej për të ushtruar tryzni ndaj Kosovës që kjo e fundit të pranojë bisedat për statusin me kushtet e vëna nga Serbia. Kjo më nuk është e mundur.²⁰ Në projekt-rezolutën e dërguar në Asambleshën e Përgjithshme të OKB-së, më 28 korrik, 2010, Serbia bëri thirrje për bisedime mbi “të gjitha çështjet e rëndësishme”, duke mos përmendur haptazi statusin e Kosovës.²¹ Duke mbajtur procesin politik në këmbë, Serbia po mundohet të vonojë njohjet e Kosovës, por zyrtarë serbë kanë bërë të ditur se janë në kërkim të një

¹⁸ Presidenti serb Boris Tadic, në fjalimin e tij në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, më 6 korrik, 2010, thotë se Serbia asnjëherë “nën çfarëdo rrethanash, direkt apo indirekt, nuk do ta njohë DNP-në”, por gjithashtu bën thirrje për “fillimin e një procesi të paqes mes shqiptarëve dhe serbëve i cili do të rezultonte në një marrëveshje të cilën do ta mbështeste secili”. UN S/PV. 6353, 6 korrik, 2010.

¹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Beograd, 15 qershor, 2010.

²⁰ Kur Serbia kërkoi nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së që kjo të kërkojë nga GJND-ja një mendim këshilldhënës, nëntë gjykatës ishin nga shtetet të cilat nuk e kishin njohur Kosovën dhe vetëm gjashtë nga ato që e kane njohur, duke lënë të kuptohet se kishte gjasa për një mendim të favorshëm. Mirëpo, gjyqatret e GJND-së janë të pavarur dhe disa prej tyre nuk kishin votuar në pajtim me qëndrimet diplomatike të shteteve prej nga vijnë. Gjyqtari Koroma nga Sierra Leone që nuk njohë Kosovën nuk u pajtua, kurse gjyqtarët Cancado Trindade dhe Sepulveda-Amor (Brazil dhe Meksikë, asnjëra nuk kanë njohur Kosovën) votuan përkrah shumicës. Tri shtete me gjyqtarë në GJND njohën Kosovën para se të jepej mendimi (Jordania, Zelanda e Re dhe Somalia).

²¹ Po ashtu ka kërkuar që Asambleja e Përgjithshme ta marrë parasysh se “ndarja e njëanshme nuk mund të jetë mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e çështjeve territoriale”. Projekt-rezoluta serbe, UNGA A/64/L.65, 27 korrik, 2010.

rruge të “ndershme” për tu pajtuar me humbjen permanente të Kosovës.²² Me këtë qasje të re në OKB, zyrtarët serbë kërkojnë rregulla të reja të lojës të cilat presidenti Boris Tadiç do të mund t’i shfrytëzonte për t’i takuar homologët e tij nga Kosova, pa u akuzuar se me këtë, në mënyrë implicite po e njeht pavarësinë e Kosovës.²³

Serbia nuk beson seriozisht se mund ta mbajë Kosovën. Sipas fjalëve të një diplomati shumë të afërt me pikëpamjet e Beogradit, Serbia nuk dëshiron ta rregullojë martesën por dëshiron një “divorc të civilizuar”.²⁴ Beogradi vazhdon të shpresojë se do të mund ta detyrojë Prishtinën që të heq dorë nga Veriu i populluar me serbë si dhe t’u japë statusin e eksteritorialitetit disa manastireve ortodokse mesjetare. Në këtë mënyrë, Serbia do të mund ta fitonte besimin e qytetarëve të saj dhe përkrahjen e nevojshme për ta proceduar çështjen e statusit të Kosovës në referendum, siç parashihet me kushtetutën e Serbisë.²⁵

Nën udhëheqjen e presidentit Tadiç dhe sidomos pas mendimit të GJND-së, Serbia ka filluar t’i shqyrtojë opsionet e ndarjes më pajtim të dyanshëm apo njohje të ndërsjellë. Në një letër dërguar Këshillit të Sigurimit më 6 korrik, Tadiç parashikonte se Asambleja e Përgjithshme do të “inkurajonte palët që të arrijnë një zgjidhje konsensuale në mënyrë paqësore dhe me dialog për të gjitha çështjet e rëndësishme”.²⁶ Gjuhë e njëjtë është përdorur edhe në rezolutën e Serbisë të dorëzuar në Asambleshën e Përgjithshme të OKB-së, ku “merret parasysh” mendimi i GJND-së dhe me të cilën “u bëhet thirrje palëve që përmes dialogut paqësor të gjejnë zgjidhje të pranueshme për të dyja palët mbi të gjitha çështjet e rëndësishme”.²⁷ Pas konsultimeve me Brukselin, Beogradi menjanoi të gjitha pikat ku përmendej statusi, pasi që kuptoi se kjo do të ishte e papranueshme për Prishtinën. Mëgjithatë, në tekst mbeti preambula provokative që dënonte “ndarjen e njëanshme”, e cila “nuk mund të jetë mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e çështjeve territoriale”.²⁸ Serbia

²² Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë serbë, Beograd, 15-16 qershor, 2010.

²³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 15 qershor, 2010. Zyrtarë të lartë serb të ministrisë së jashtme kanë shkruar në Shqipëri, duke kërkuar një “kompromis historik” me Kosovën; intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të lartë shqiptarë, Tiranë, 27 e 27 korrik, 2010.

²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 19 janar, 2010.

²⁵ Raporti për Evropë i Grupit të Krizave, numër 44, *Kushtetuta e re e Serbisë: Demokracia shkon prapa*, 8 nëntor, 2006

²⁶ UN S/PV. 6353, 6 korrik, 2010.

²⁷ Projekt-rezoluta serbe, op. cit. Teksti është i ngjajshëm me thirrjen e BE-së, duke vënë re “synimin për arritjen e paqes, sigurisë dhe bashkëpunimit në rajon”.

²⁸ Ibid. Preambula me gjasë është hartuar që t’u pelqejë shteteve të brengosura për lëvizjet e mundshme separatiste në territoret e tyre; por duke e përshkruar mosmarrëveshjen themelore si

pranon që bisedimet të mbahen me ndërmjetësimin e BE-së me një rol shumë të vogël të OKB-së, duke e ditur se Kosova do të refuzojë të marrë pjesë në një proces të udhëhequr nga OKB-ja, por insiston në negociata pa ndonjë kufizim kohor dhe ku asnjë temë nuk do të përjashtohet. Për të filluar, çmimi të cilin e kërkon Serbia për njohjen e pavarësisë është Veriu i Kosovës.

Ekziston një pajtim i gjithëmbarshtëm mes partive politike në Beograd se Kosova për Serbinë është njëjtë sikurse Veriu që është për Kosovën. Rrjedhimisht, ofertave të ndërkombëtarëve për autonomi të zgjeruar për serbët e Veriut përbrenda Kosovës, Beogradi i përgjigjet me ofrimin e autonomisë për Kosovën brenda Serbisë – që është thjesht një mënyrë tjetër për të thënë “jo”. Serbia reagon në të njëjtën mënyrë ndaj presioneve për njohjen e realitetit të pavarësisë së Kosovës duke thënë se “çdokush duhet ta pranojë se në Veri të lumit Ibër ekziston një realitet tjetër”.²⁹ Shumica e serbëve të Veriut mendojnë kështu: nëse Kosova mund të jetë e pavarur nga Beogradi, atëherë edhe ata do të duhej të ishin të pavarur nga Prishtina.³⁰

Klima politike në Beograd ka ndryshuar në favor të asaj që Tadiç e quante “kompromis historik” në mes të serbëve e shqiptarëve.³¹ Partitë politike me qëndrime më radikale në lidhje me Kosovën sikurse Partia Demokratike e Serbisë (DSS) dhe Partia Radikale Serbe (SRS) janë të dobëta, duke pasur vetëm pak më shumë se 5 përqind, pragu që duhet të kalohet për të pasur deputetë në parlament. Partia më e fortë opozitare, Partia Progresive Serbe (SNS) ka filluar të tregojë qasjen e saj pro-perëndimore ndërsa jozyrtarisht pranon se dëshiron që qeveria e tanishme ta zgjidhë çështjen e Kosovës në mënyrë që qeveria e ardhshme, të cilën shpresojnë ta udhëheqin vetë, të mund të fillojë në një faqe të pastër.³² Tadiç dhe partia e tij në qeveri, Partia Demokratike (DS), në fakt kanë mbështetje të madhe për një zgjidhje përmes bisedimeve. Më 27 korrik të këtij viti, parlamenti ka aprovuar rezolutën e sponsorizuar nga qeveria e cila përsëriste premtimin se kurrë nuk do të pranohet “deklarata e njëanshme e pavarësisë” porse mbështet arritjen e “kompromisit historik”.

Opinionin publik në Serbi është lodhur nga problemi i Kosovës dhe dëshiron që kjo të përfundojë, edhe pse ka gjasa që elementë nationalist të dalin fuqishëm kundër çfarëdo njohjeje të shtetit të pavarur. Zyrtarët qeveritarë

besojnë se do të mund t'i ofrojnë shumicës së qytetarëve një zgjidhje të pranueshme, përdërisa merren parasysh kërkesat e tyre për Veriun dhe kishat.³³ Kjo është thelbësore pasi që për çfarëdo marrëveshje do të nevojitet amandamentimi i kushtetutës dhe ligjeve, ndryshime këto që do të duhet të hidhen për miratim në referendum gjithëpopullor.³⁴

Ndryshime të rëndësishme ka pasur edhe në Kishën Ortodokse Serbe. Patriarku Irinej, i zgjedhur rishtaz, ka dhënë shenja për një qëndrim të ri në fjalimin e tij të mbajtur në fushën e betejës së Kosovës, duke bërë thirrje për kompromis dhe duke bërë të qartë se Kosova u takon si shqiptarëve ashtu edhe serbëve.³⁵ Në dhjetor të vitit 2009, kisha e detyroi që të japë dorëheqje Artemije Radosavljeviçin e Rashkës-Prizren, klerikun më me ndikim dhe më radikal të Kosovës. Artemije u pensionua në manastirin e Vojvodinës. Pasardhësi i tij i mundshëm, Teodosije Shibalich i Lipjanit, konsiderohet si njeri që përkrah përmirësimin e raporteve ndëretnike.

B. KËNDVËSHTRIMI KOSOVAR

Kosova nuk është aq entuziaste sa i përket bisedimeve. Strategjia e saj, e udhëhequr nga SHBA-të dhe vendet tjera mike, është mbledhja graduale e njohjeve dhe konsolidimi i institucioneve të shtetit, duke mos i dhënë shumë rëndësi marrëdhënieve me Serbinë. Ajo po ashtu është e vendosur që periodha e pavarësisë së mbikëqyrtur, e parashikuar me planin e Ahtisarit e cila i jep zyrtarëve ndërkombëtarë fuqi të mëdha mbikëqyrëse e juridike, të përfundojë sa më shpejtë në mënyrë që të vazhdohet me integrimet euro-atlantike.³⁶ Është pritur që mendimi i GJND-së të nxisë njohje të reja. Duke marrë parasysh këtë, udhëheqësit e Kosovës konsideruan se është më mirë të pritet përfundimi i kësaj vale të re të njohjeve e

“çështje territoriale” janë dhënë shenja se është në rritje e sipër njohja e shtetësisë së Kosovës nga Serbia.

²⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 16 qershor, 2010.

³⁰ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë serbë të Veriut, Mitrovicë. Laposaviq/Zubin Potok, mars-korrik 2010; figura të opozitës të serbëve të veriut, Mitrovicë, korrik, 2010.

³¹ UN S/PV. 6353, 6 korrik, 2010.

³² Intervistë e Grupit të Krizave, Beograd, 24 korrik, 2009.

³³ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë serbë, Beograd, 10 mars, 15-16 qershor, 2010.

³⁴ Preambula e kushtetutës serbe thotë “Duke marrë parasysh edhe faktin se provinca e Kosovës dhe Metohisë është pjesë integrale e territorit të Serbisë, se ka statusin e autonomisë substanciale përbrenda shtetit sovran të Serbisë dhe se si pasojë e këtij statusi province e Kosovës e Metohisë ndjek obligimet kushtetuese të të gjitha trupave shtetëror me qëllim të mbrojtjes së interesave shtetërore të Serbisë në Kosovë e Metohi, në të gjitha marrëdhëniet politike të brendshme e të jashtme”, dhe neni 203 specifikon se amandamentet e preambulës për tu miratuar duhet të hidhen në referendum.

³⁵ Fjalimi i Patriarkut, ceremonia e Vidovdanit, Graçanicë, RTS-TV, 28 qershor, 2010. Beteja e Kosovës, në të cilën forcat serbe ishin mposhtur nga ato të Perandorisë Osmane, në vitin 1289, konsiderohet si datë e shënuar në historinë serbe; shih Noel Malcolm, Kosovo: A Short History (Kosova: Një histori e shkurtër), (Nju Jork, 1998), fq 58-80.

³⁶ Fjalim publik i kryeministrit Hashim Thaci, Instituti i Paqës i Shteteve të Bashkuara (USIP), 20 korrik, 2010.

pastaj të fillohet të bisedohet me Beogradin. Por, pasi që asnjë njohje e re deri më tani nuk ka ardhur në adresë të Prishtinës, udhëheqësit kosovarë janë duke e rishqyrtuar këtë strategji.

Kryeministri Thaçi ka kuptuar se negociatat që i janë ofruar nuk mund të refuzohen. Edhe para vendimit të GJND-së, ai kishte theksuar se i mirëpret bisedimet ku të dyja palët janë të barabarta dhe ku do të diskutohet për çështje teknike, duke përfshirë këtu: problemet e shkaktuara nga lufta, bashkëpunimin rajonal, çështje të interesit të dyanshëm për krijimin e një ambienti të sigurtë si dhe zhvillimin ekonomik. Ai përjashtoi mundësinë që të bisedohet për statusin politik dhe integritetin territorial si dhe çështje tjera që nuk janë në përputhshmëri me planin e Ahtisarit dhe kushtetutën e vendit.³⁷ Thaçi dhe qeveria e tij zakonisht nuk i japin rëndësinë e duhur njohjes nga Serbia duke thënë se ka ardhur koha që Serbia të mos e pengojë pjesëmarrjen e Kosovës në institucionet rajonale.

Udhëheqësia e Kosovës nuk dëshiron që të pranojë ndryshime të planit të Ahtisarit. Një zyrtar i lartë thotë se çdo shqiptar beson se Kosova kishte dhënë më shumë se që duhej me pranimin e këtij plani.³⁸ Përdersia shumë kosovarë e “urrejnë” këtë plan, ata gjithashtu e shohin atë si një kontratë të bërë me botën dhe si të tillë duhet respektuar.³⁹ Disa besojnë se pjesa e kontratës që i përket decentralizimit, e cila i favorizon serbët, nuk do të duhej të implementohej në jug të Ibrit pa marrjen paraprake të kontrollit mbi Veriun.⁴⁰ Sipas një ministri të qeverisë së Kosovës, vetëm pas fillimit të procesit të decentralizimit komuniteti ndërkombëtar filloi ta përmend çështjen e një autonomie të zgjeruar për Veriun.⁴¹ Por të tjerët vlerësojnë se decentralizimi i pjesëve të banuara kryesisht me serbë në jug të Ibrit ka qenë një nga sukseset kryesore të Kosovës.

Në çfarëdo dialogu me Serbinë, kryeministri do të jetë figura kryesore vendimmarrëse. Koalicioni që ai udhëheq, i përbërë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e presidentit Fatmir Sejdiu, është në pushtet qysh nga muajt e parë të vitit 2008 dhe në përgjithësi respektohet për menaxhimin e situatës para dhe pas shpalljes së pavarësisë. Ka shumicën në parlament edhe pse së fundmi është dobësuar për shkak të dyshimeve për korrupsion që mund të përcillen edhe me arrestime të zyrtarëve të lartë.

Opozita përkrah fuqishëm planin e Ahtisarit por është kritike ndaj paaftësisë për integrimin e Veriut të vendit dhe bën thirrje për përpjekje më të mëdha të bashkësisë ndërkombëtare për të ruajtur integritetin territorial të Kosovës. Megjithatë, tri partitë kryesore opozitare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e Ramush Haradinajt, Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) e Nexhat Daci dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) e Behgjet Pacollit nuk kanë formuar një front të përbashkët. Partitë politike të reja që pritet të marrin pjesë në zgjedhjet e vitit 2011, sikurse ish-lëvizja Vetëvendosje, nuk pritet të kontribuojnë në çfarëdo dialogu mes Kosovës e Serbisë.

Gjatë negociatave të fundit me Serbinë, para shpalljes së pavarësisë, Kosova kishte formuar Ekipin e Unitetit, i cili përfshinte përfaqësuesit e partive kryesore politike. Partitë opozitare të udhëhequra nga AAK-ja, kërkojnë që një formacion i tillë të krijohet përsëri.⁴² Qeveria do të jetë ajo që do të udhëheqë çfarëdo dialogu. Por, zyrtarë qeveritarë pranojnë se nëse dialogu shkon përtej çështjeve teknike, një konsultim dhe koordinim i të gjitha partive do të jetë i nevojshëm.⁴³ Të gjitha forcat politike lokale janë pajtuar që të marrin pjesë në prodhimin e ideve (brainstorming), proces ky i udhëhequr nga shoqëria civile me qëllim të gjetjes së pozicioneve të përbashkëta,⁴⁴ edhe pse shoqëria civile është shumë më pak fleksibile se sa opozita. Një nga udhëheqësit i kishte thënë Grupit të Krizave: “Jam përpjekur shumë për implementimin e planit të Ahtisarit. Nëse Veriut i jepet autonomia, unë do të jem ndër të parët që të pëpiqen ta ndalojnë implementimin e këtij plani në jug të vendit”⁴⁵.

Mirëpo, fleksibiliteti i qeverisë ndoshta është dëmtuar nga deklarata e Gjykatës së Hagës për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi (ICTY), të bërë më 19 korrik, 2010, që thoshte se Haradinaj do të akuzohet për herë të dytë në lidhje me krimet e luftës.⁴⁶ Ish-kryeministri i Kosovës dhe komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UCK) ndoshta është i vetmi kundërshtar i denjë i Thaçit. Ky veprim i Hagës si dhe vendimi për ta paraburgosur në pritje të gjyqimit (edhe pse zakonisht të akuzuarit lirohen me kusht), e bën shumë më të vështirë pranimin e kompromiseve nga ana e qeverisë pa mbështetjen e plotë të opozitës. Një situatë e tillë do të mund ta ngadalësojë dhe ta

³⁷ Ibid.

³⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, presidenti Fatmir Sejdiu, Prishtinë, 15 mars, 2010.

³⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë qeveritar, Prishtinë, 18 qershor, 2010.

⁴⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë lokale, Prishtinë, 20 gusht, 2009.

⁴¹ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 2 korrik, 2010.

⁴² Intervistë e Grupit të Krizave, lider i opozitës, Prishtinë, 14 korrik, 2010.

⁴³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë, Prishtinë, 5 korrik, 2010.

⁴⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, aktivist i shoqërisë civile, Prishtinë, 21 korrik, 2010.

⁴⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 19 korrik, 2010.

⁴⁶ IT-04-84-A, Prokurori v. Ramush Haradinaj et al., Gjykimi, 19 korrik, 2010. Ai ishte shpallur i pafajshëm më 3 prill, 2008. Dhoma e ankësave ritheksoi 6 nga 37 akuzat origjinale, përfshirë këtu vrasjen, torturimin, trajtimin e vrazhdë dhe burgosjen e paligjshme të civilëve.

bëjë më të rrezikshëm vendosjen e marrëdhënieve me Serbinë.

C. KËNDVËSHTRIMI I NDËRKOMBËTARËVE

Menjëherë pas dhënies së mendimit nga GJND-ja, BE-ja doli me ofertën që të "lehtësojë procesin e dialogut... të promovojë bashkëpunimin, të shënojë përparim në rrugën drejt Evropës dhe të përmirësojë jetën e përditshme të popullsisë".⁴⁷ Deri më tani duket se BE-ja preferon biseda të hapura mbi çështjet teknike dhe praktike.⁴⁸ Duke qenë e vetëdijshme për zgjedhjet e vitit 2011 në Kosovë dhe ato të vitit 2012 në Serbi, dhe për shkak të nevojës për përparim në Ballkanin perëndimor, BE-ja së bashku me SHBA-në, është e interesuar që të fillojë ndërmjetësimin e dialogut, në vjeshtë të këtij viti. OKB-ja ka ofruar që të "bashkëpunojë ngushtë dhe të koordinojë" procesin.⁴⁹

Për të qenë e besueshme në udhëheqjen e këtij procesi, BE-ja duhet të mbajë një qëndrim të përbashkët në lidhje me projekt-rezolutën e propozuar nga Serbia në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, që pritet të mbahet në gjysmën e shtatorit.⁵⁰ Në ditët para dorëzimit të projekt-rezolutës, zyrtarë të lartë evropianë dhe ata të OKB-së kanë theksuar se duket sikur Beogradi nuk po e kupton se rezoluta mund të "përplasë" me BE-në.⁵¹ Serbia i iku me dinakëri konsultimeve, duke i bërë thirrje diplomatëve evropianë e amerikanë që të propozojnë amandamente, dhe duke e dërguar tekstin e rezolutës vetëm disa orë më pas, pa pritur përgjigje nga ta.⁵² Ambienti i mirë i krijuar nga bisedat e kaluara me Brukselin dhe vendimi për të hequr referencën mbi statusin shkuan huq, dhe shumë nga diplomatët, sidomos ata evropianë, ishin tejet kritikë.⁵³

Megjithatë, BE-ja ende shpreson se do t'ia arrijë ta hartojë një tekst të ri me Serbinë dhe në bashkëpunim të ngushtë me SHBA-në.⁵⁴ Para dhënies së mendimit nga

GJND-ja, BE-ja anonte kah një qasje minimaliste: rezolutë të shkurtër, e cila "merr parasysh" vendimin e gjykatës. Kjo do të duhej të arrihej vetëm pasi që Serbia dhe Kosova të kenë pranuar paraprakisht ftesën e BE-së për fillimin e dialogut.⁵⁵ Brukseli tani kërkon një rezolutë e cila e "mirëpret" mendimin e GJND-së dhe refuzon preambulën e draftit të Serbisë, që përmban dënimin shumë të vrazhdë të "ndarjes së njëanshme".⁵⁶

As palët e as ndihmësit e tyre eventualë nuk kanë sqaruar se çfarë do të ndodhë pas rezolutës, si do të organizohen negociatat dhe se cilat do të jenë qëllimet e tyre.⁵⁷ Deri tani, BE-ja dhe SHBA-të nuk besojnë se palët do të ishin të gatshme të flasin për çështjen e njohjes në fazat e para të bisedave. Në vend të kësaj, ata e konsiderojnë "procesin e dialogut" si arritje në vetvete me ç'rast do të kontribuohet në "paqe, siguri dhe stabilitet në rajon".⁵⁸ Ata parashikojnë një proces të gjatë të vendosjes së marrëdhënieve Kosovë-Serbi i cili do të fillonte me bashkëpunim teknik, duke injoruar fillimisht çështjen e statusit. Procesi do të mund të rezultonte me njohje vetëm në fazat e mëvonshme.⁵⁹

Sipas tyre, zgjidhja e problemeve teknike në fillim të bisedave do të mund të krijonte mirëbesim të dyanshëm që është i nevojshëm për zgjidhjen e problemeve më të mëdha politike dhe për vendosjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore, që janë kriter i padiskutueshëm për integrim në BE.⁶⁰ Por deri më tani kjo qasje ka dështuar: politika lëvizëse (shuttle) e BE-së për të mundësuar që Kosova e Serbia të merren vesh në lidhje me çështje themelore, sikurse gjykatat dhe policia në Veri, vetëm sa e ka tensionuar situatën në Prishtinë.⁶¹ Për të pasur përparim të vërtetë nevojiten takime sy më sy të liderëve më të lartë, ku presidenti Tadiç dhe kryeministri Thaçi do të takohehin si të barabartë. Kjo ka pak gjasa të ndodhë nëse bise-

⁴⁷ "Deklaratë nga përfaqësuesi i lartë Ketrin Eshton në emër të BE-së në lidhje me mendimin këshilldhënës të GJND-së", deklaratë për media, BE, 22 korrik, 2010.

⁴⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së dhe SHBA-së, Prishtinë dhe Bruksel, korrik, 2010.

⁴⁹ Sidomos në pjesët ku ajo ka "njohuri dhe përvojë të vecantë". Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për UNMIK-un, UNSC S/2010/401, 19 korrik, 2010, fq. 10.

⁵⁰ Serbia pritet të paraqesë formalisht rezolutën e saj më ose rreth datës 14 shtator. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i OKB-së, Nju Jork, 17 gusht, 2010.

⁵¹ Intervista të Grupit të Krizave, diplomat i BE-së, Paris, 5 korrik, 2010; zyrtar i OKB-së, Beograd, 22 korrik, 2010.

⁵² Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat i BE-së, Beograd, 30 korrik, 2010.

⁵³ Ibid. "Tadic: Serbia është konsultuar me parterët evropianë mbi rezolutën për Kosovën", gazeta ditore VIP, 2 gusht, 2010.

⁵⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Bruksel, 6 gusht, 2010.

⁵⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat i BE-së, Paris, 5 korrik, 2010.

⁵⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat i BE-së, Beograd, 30 korrik, 2010.

⁵⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat i BE-së, Bruksel, 6 gusht, 2010.

⁵⁸ "Deklaratë nga përfaqësuesi i lartë Ketrin Eshton", op. cit. Gjuhë e njejtë në rezolutën serbe lë të kuptohet se Beogradi e pranon këtë qëllim, por e sheh si rezultat, e jo si proces të një zgjidhje gjithëpërfshirëse politike.

⁵⁹ Ndihmës-sekretari i shtetit amerikan, Filip Gordon ka thënë se Serbia dhe Kosova do të duhet të "lënë [njohjen] menjanë dhe të tregojnë se mund të punojnë rreth çështjeve që janë me interes për qytetarët që jetojnë atje, kurse çështja e njohjes mund të shqyrtohet më vonë". Konferencë për shtyp përmes telefonit, 23 korrik, 2010.

⁶⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i BE-së, Bruksel, korrik, 2010.

⁶¹ Raporti për Evropë i Grupit të Krizave, numër 204, *Sundimi i ligjit në Kosovën e pavarur*, 19 maj, 2010, fq. 18-22.

dat kufizohen vetëm në dogana, tregti, energji elektrike, transport e çështje të ngjajshme.

Gjuha e mprehtë por elastike e ftesës së BE-së për bisedime është në pajtim me qëllimet për bashkëpunim të nivelit të ulët por mund të zgjerohet më tej dhe të përfshijë çështjet fundamentale për njohje të ndërsjellë.⁶² Ndërmjetësit ndërkombëtarë nuk do të duhej të impononin një agjendë të vetme apo të ndalojnë dikustimin e çfarëdo teme. Që të dyja këto vendime duhet të merren nga Kosova dhe Serbia. Roli i ndërkombëtarëve duhet të jetë i kufizuar, së paku në këtë fazë, në mënyrë që asnjëra palë të mos ketë përparësi jolegjitime procedurale. Sikur Serbia që frikësohet se pjesëmarrja në forume ndërkombëtare së bashku me zyrtarët kosovarë do të përdorej si argument për njohjen implicite të pavarësisë, ashtu edhe Kosova është e brengosur se vënia e ndryshimit të kufijve në tavolinën e bisedimeve do të rrezikonte integritetin e saj territorial. Bisedimet do të duhej t'u jepnin hapësirë palëve që të diskutojnë të gjitha çështjet pa pasur frikë se do të mashtrohen.

Ndërmjetësuesit ndërkombëtarë e dinë se për të pasur negociata të suksesshme, Serbia dhe Kosova do të duhej të ndryshojnë qëndrimet e tyre armiqësore dhe të jenë më fleksibil me qëllim të arritjes së kompromisit. Serbia nuk ka qenë agresive vetëm me fjalë por e ka dëmtuar Kosovën duke ia penguar pjesëmarrjen në forume rajonale e ndërkombëtare. Hapja e zyreve përfaqësuese konsullore, pa akreditim diplomatik në të dyja kryeqytetet do të ishte hap i dobishëm në ndërtimin e besimit me rastin e fillimit të bisedave. Një gjë të tillë e kishte bërë Republika Federative e Jugosllavisë e dominuar nga serbët, në mars të vitit 1994, kur kishte hapur zyren e saj në Zagreb edhe pse forcat e saj ende kontrollonin territorin e Kroacisë.⁶³ Këto zyre në Beograd e Zagreb u ndihmuan njerëzve që të zgjidhin çështjet personale që u shfaqën si pasojë e dezintegritimit të ish-Jugosllavisë, siç janë të drejtat pronësore, pensionet, dokumentet e nënshtetësisë, vizat dhe certifikatat e lindjes dhe martesës. Serbia do të duhej të punonte që serbët e Mitrovicës Veriore të mirëpresin zyren e qeverisë së Kosovës të hapur rishtaz, e cila ka për qëllim të kryejë një detyrë të tillë.

Bisedat duhet të fillojnë sa më parë që është e mundur. Udhëheqësit e partive politike të Kosovës nuk do të jenë të gatshëm të diskutojnë pas zgjedhjeve të vitit 2011 nga frika se çështjet kontraverze do të mund t'ua dëmtonin

kampanjat parazgjedhore.⁶⁴ Në të njëjtën pozitë do të jenë edhe politikanët serbë në fillim të vitit 2012. Nëqoftëse nuk arrihet ndonjë përparim thelbësor deri në pranverë të 2011-s, marrëdhëniet Kosovë-Serbi do të mund të ngrihen për më së paku dy vitet e ardhshme. Gjithashtu, edhe konteksti ndërkombëtar mund të bëhet më i komplikuar qysh në janar të 2011-ës kur pritet që Sudani Jugor të mbajë referendumin për vetëvendosje. Shtetet që nuk kanë vendosur ende për njohjen e pavarësisë së Kosovës, kryesisht ato të kontinentin afrikan, do të mund të vazhdonin me një qëndrim të tillë, duke mos pasur dëshirë të shihen si përkrahës të secesionit.⁶⁵

⁶² Ibid.

⁶³ Shumë shtete e entitete që nuk janë të pavarura, sikurse Republika Srpska e Bosnjës, dhe shtetet federale gjermane kane përfaqësi të huaja disa prej të cilave janë më të mëdha se ambasadat e shteteve të tyre.

⁶⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë qeveritar, Prishtinë, 18 qershor, 2010.

⁶⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, ministër i jashtëm, shtet anëtar i BE-së, Bruksel, qershor, 2010.

III. VERIU: TRI OPSIONE

Pika kryesore e mosmarrëveshjes mes Kosovës e Serbisë është Veriu i Kosovës, një sipërfaqe e vogël me rreth 1,000 kilometra katrorë, që përfshin në vetë si të plota tri komuna (Zbin Potoku, Leposaviqi dhe Zveqani) dhe gjysmën e komunës së Mitrovicës.⁶⁶ Në mënyrë implicite, Serbia pranon se tokat në jug të lumit Ibër i takojnë Kosovës por kërkon që ta mbajë dhe ta formalizojë më tutje kontrollin që ka në Veri. Ky qëndrim është në kundërshtim me ambiciet e Prishtinës për integrimin e kësaj pjese dhe për sigurimin e kufirit të saj verior. Nëse Kosova dhe Serbia arrijnë të pajtohen në lidhje me Veriun, atëherë ato do të jenë në një pozitë të volitshme për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Mosmarrëveshjet tjera janë shumë më të thjeshta dhe më pak kundërtënëse. Por e kundërta është e vërtetë po ashtu. Pa zgjidhjen e çështjes së Veriut, vetëm ndonjë zgjidhje e përkohshme do të ishte e mundur.

Prishtina dhe Beogradi mund të zgjedhin njëri nga tri strategjitë për Veriun apo të mbajnë “status-quo”-n dhe eventualisht të krijojnë një konflikt të ngrirë. Secila zgjidhje – plani i Ahtisarit, autonomia e zgjeruar apo shkëmbimi i territoreve – bartë me vete sfida e rreziqe. Në analizat e mëhershme, Grupi i Krizave ka përkrahur fuqishëm planin e Ahtisarit dhe ka paralajmëruar për rrezikun e ndryshimit të kufijve me anë të ndarjes. Një politikë e tillë ishte solide dhe çoi drejt pavarësisë së suksesshme të Kosovës. Por rrethanat e sotme ku Kosova ka një pozicion më të fuqishëm politik, kur në Beograd ekziston një qëndrim i ri dhe kur ka fakte të pamohueshme se bashkësia ndërkombëtare nuk është e interesuar të imponojë ndonjë zgjidhje, bëjnë që t’i rishqyrtojmë analizat tona.

Qasja e tanishme ka dështuar në dy aspekte: ajo nuk i ka dhënë Kosovës legjitimitetin ndërkombëtar i cili do të miratohej nga një rezolutë e re e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe në anën tjetër nuk e ka ndihmuar integrimin e Veriut. Negociatat gjithëpërfshirëse do t’u jepnin mundësi palëve që ti shqyrtojnë këto çështje, me fokus të veçantë në njohjen e dyanshme dhe Veriun. Për të marrë njohjen, asnjëra nga opsionet për Veriun nuk do të duhej të lihen menjatë as nga palët negociatore e as nga lehtësuesit ndërkombëtarë. Nëqoftëse janë pjesë e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse përfshirë edhe njohjen, cilado nga tri opsionet do të ishte më e mirë dhe më pak e rrezikshme sesa forcimi i “status quo”-së.

⁶⁶ Plani i Ahtisarit parasheh ndarjen e Mitrovicës përgjatë lumit Ibër, në 2 komuna, atë të veriut dhe te jugut, por ky plan nuk është implementuar për shkak të refuzimit të serbëve të veriut që ta pranojnë rezultatin e procesit të Ahtisarit.

A. PLANI I AHTISARIT DHE REALITETI I VERIUT

Numri i popullsisë në veri të Kosovës sillet prej 45,000 deri në 72,000.⁶⁷ Grupi i Krizave beson se numri i vërtetë është më afër numrit 45,000 por duhet të pritët deri në regjistrimin e radhës që do të bëhet në prill, 2011.⁶⁸ Më shumë se 95 për qind të popullatës janë serbë, të cilët kanë shumë pak kontakt me shqiptarët e Kosovës. Në vitin 1959, pjesë të mëdha të komunës së Rashkës (Serbi) i janë ngjitur asaj të Leposaviqit për të rritur numrin e popullsisë serbe.⁶⁹

Gjate luftës së vitit 1999, policia serbe ka vlarë figura të njohura të shqiptarëve të Mitrovicës si dhe ka larguar nga shtëpitë e tyre me mijëra njerëz, përdërisa “shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës janë djegur sistematikisht”.⁷⁰ Qysh nga ajo kohë, vetëm një numër i vogël i shqiptarëve është kthyer në veri të Mitrovicës. Përpjekjet për ta kaluar urën në vitin 1999 dhe 2000 rezultuan me përleshje të mëdha; në të njëjtën kohë, serbët lëshuan jugun ndërsa shqiptarët u larguan nga veriu. Sipas të dhënave të vitit 2009 të Policisë së Kosovës, 21 serbë kanë jetuar ne jug të qytetit në territorin e kontrolluar prej Këtij stacioni policor, dhe 2,200 shqiptarë në territorin e kontrolluar në

⁶⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, ish-deputetë I DS-së, Mitrovicë, maj 2008 (numri më i vogël); të dhëna të vitit 2009 nga drejtorati rajonal i policisë së Mitrovicës i dhënë Grupit të Krizave (numri më i lartë). Vizita të shumta të Grupit të Krizave në fshatrat dhe qytetet veriore tregojnë depopullizim të madh si pasojë e mungesës së vendeve të punës dhe tokës relativisht të papunueshme. Regjistrimi jugosllav i vitit 1991 tregon se numri i popullsisë në Zveqan, Zubin Potok e Leposaviq është 35,021 – në Zveqan kanë qenë 10,030 njerëz, prej tyre 7,591 serbë dhe 1,934 shqiptarë; Zubin Potoku kishte 8,700 njerëz (7,750 serbë dhe 850 shqiptarë); Leposaviqi kishte 16,291 njerëz (14,306 serbë dhe 1,101 shqiptarë). Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në profilet e komunave të vitit 2006, thotë se numri i popullsisë në këto tri komuna është rritur në 46,000. Numri i popullsisë së Mitrovicës veriore është i panjohur, edhe pse në raportin e profileve të komunave të OSBE-së të vitit 2009, ky numër llogaritet të jetë rreth 20,000 (prej të cilëve 17,000 serbë dhe gati 7,000 persona të identifikuar). Një artikull kishte llogaritur se numri i popullsisë në veri të Kosovës është rreth 70,000 (66,000 serbë, 4,000 boshnjakë, goranë, shqiptarë dhe turq), Batic Bacevic, “Kako do podele Kosova” [Si të ndahet Kosova], *NIN*, 15 korrik, 2010.

⁶⁸ Zyra Statistike e Kosovës – www.ks-ov.net/ESK/eng.

⁶⁹ Tokat e shtuara përfshinin vendbanime si Leshaku, Postenja, Bellobërda, Dreni dhe Beluce.

⁷⁰ Prokurori v. Millan Millutinovic et al., Gjykimi, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Lugte në ish-Jugosllavi, IT-05-87, 26 shkurt, 2009, vëllimi 2, fq. 253-266, 430.

veri,⁷¹ kryesisht në lagjen e Boshnjakëve, Brdjani/Kroi i Vitakut dhe Suhadoll.

Plani i Ahtisarit i ofron pjesëve të banuara me serbë autonomi të gjërë dhe formale, duke përfshirë edhe lidhjet financiare me Serbinë.⁷² Nëse implementohet, komunat ekzistuese serbe do të funksiononin pa ndonjë ndikim të madh të Prishtinës, falë procesit të decentralizimit; komuna e re e Mitrovicës së Veriut do të kishte kompetenca të zgjeruara në shëndetësi dhe shkollimin e lartë.⁷³ Komunat e vjetra dhe të reja, në të dyja anët e Ibrit, do të kishin të drejtën e formimit të asociacioneve me synime dhe interesa të përbashkëta dhe në të njëjtën kohë do të mbanin lidhje me komunat dhe institucionet në Serbi.⁷⁴

Përkundër meritave të shumta që ka, plani i Ahtisarit refuzohet fuqishëm nga thujtja të gjithë serbët e Veriut. Zyrtarët e komunave paralele deklarojnë se “ne tashmë kemi gjithçka që ofrohet nga ai plan dhe duke e pranuar atë vetëm se i japim Prishtinës atë që ajo dëshiron: legjitimitetin”.⁷⁵ Poashtu, një tjetër qëndrim i përbashkët është se “plani i Ahtisarit nënkupton të jetohej në Republikën e Kosovës. Ne jetojmë në Republikën e Serbisë, dhe nuk është e drejtë të detyrohemi të jetojmë në Republikën e Kosovës nëse ju keni refuzuar t’i detyroni shqiptarët të jetojnë në Republikën e Serbisë”.⁷⁶ Ata të cilët mbështesin planin e Ahtisarit janë kryesisht anëtarë të partive të vogla politike të cilat marrin pjesë në sistemin politik të Kosovës, por të cilat nuk janë as kredibile e as efektive. Serbët e Veriut ankohen se prania e vogël e policisë dhe gjykata e bllokuar kanë bërë të pamundur procedimin e lëndëve të rajonin e Mitrovicës, por refuzojnë çfarëdo zgjidhje që do të mund t’i fuste ata “si pjesë të Republikës së Kosovës”.⁷⁷

Megjithatë, rezultati që dëshiron Prishtina në fund është integrimi i plotë i Veriut në sistemin e saj legal. Zyrtarët e Kosovës thonë se Beogradi është duke ushtruar presion ndaj serbëve që ata të mos bashkëpunojnë ndërsa përkrah ekstremistët të cilët “terrorizojnë” popullatën lokale; sipas tyre, nëqoftëse ndalen kërcënimet fizike, financiare dhe verbale, atëherë serbët do të bashkëpunonin me institu-

cionet e Kosovës.⁷⁸ Por disa zyrtarë shqiptarë e të huaj mendojnë se ky është një mendim i bukur por jo edhe realist. Një diplomat evropian me përvojë të gjatë në rajon thotë se të pritët që rregullat e njejta të vlejnjë edhe në Veri është “totalisht joreale” dhe “dështimi kryesor” i planit të Ahtisarit.⁷⁹

Veriu i vendit nuk është nën kontrollin e Prishtinës qysh kur Jugosllavia miratoi kushtetutën e Slllobodan Millosheviçit, në vitin 1989.⁸⁰ Gjatë periudhës së UNMIK-ut, Veriu ka qenë ngushtë i lidhur me pushtetin qendror në fushën e gjykatave dhe doganave, por këto lidhje janë dëmtuar rëndë më shpalljen e pavarësisë. Zgjedhjet paralele serbe më 11 maj, 2008, kanë prodhuar administrata komunale të cilat janë integruar në sistemin qeveritar të Serbisë.⁸¹ Fill pas shpalljes së pavarësisë, serbët e Veriut dogjën pikat kufitare; edhe pse më vonë u rindërtuan, ato nuk janë shumë efektive.⁸² Gjyqtarët serbë, të cilët punojnë kryesisht jashtë shtepive të tyre, ofrojnë shërbime të bazuara në ligjin serb.⁸³

Qysh nga viti 1989, sistemi i edukimit është udhëhequr nga Serbia. Universiteti i quajtur “Universiteti i Prishtinës përkohësisht i stacionuar në Mitrovicë” me rreth 10,000 studentë është rritur qysh nga viti 1999 me rastin e largimit të profesorëve nga jugu i Kosovës.⁸⁴ Kjo i jep Mitrovicës së Veriut një koncentrim më të madh të të rinjëve në krahasim me pjesët tjera serbe në Kosovë. Kampusi universitar është konkurrent i denjë i cilitdo

⁷⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i qeverisë së Kosovës, Prishtinë, 13-14 korrik, 2010.

⁷⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i OKB-së, Prishtinë, 20 korrik, 2010.

⁸⁰ Kushtetuta nuk e ka ndryshuar pozitën formale të veriut karshi Prishtinës por i ka reduktuar dukshëm kompetencat e Kosovës dhe në fakt ka imponuar sundimin serb në tërë provincën, duke eliminuar ndikimin e Prishtinës me shumicë shqiptare.

⁸¹ Grupi i Krizave ka vërtetur zyrat e UNMIK-ut në komunat e veriut me flamurin e UNMIK-ut dhe ate serb në hyrje të ndërtesës, në qershor, 2010. Komunat paralele në Veri, për ndryshim prej institucioneve të ngjajshme nëpër enklava, kanë staf dhe departamente shtesë sikurse ato për mbledhjen e mbeturinave, planifikimin urban, shëndetin urban, sistemin e ujit, punimet publike e edhe departamentin për mbrojtjen e mjedisit.

⁸² Pikat kufitare 1 dhe 31 afër Zubin Potokut dhe Leposaviqit kanë numër të vogël të zyrtarëve të EULEX-it dhe gati asnjë polic të PK-së. Kamionët me të mira materiale shënohen dhe për to i raportohet terminalit doganor në jug të Mitrovicës, vetëm nëse ato kalojnë lumen Ibër. Përndryshe, mallrat që hyjnë nga Serbia dhe nuk dalin nga veriu janë të liruar nga taksat.

⁸³ Këto gjykata, me staf të ministrisë serbe të drejtësisë, merren vetëm me çështje civile; ata kanë vull të republikës së Serbisë e cila i bën valide në Serbi të gjitha vendimet e tyre në lidhje me martesë, divorce dhe trashëgimi. Por, ata nuk kanë mundësi të merren me raste të krimeve.

⁸⁴ Universiteti ka 1,627 vende të lira për vitin akademik 2010-2011. Universiteti i Prishtinës: www.pr.ac.rs.

⁷¹ Të dhëna nga drejtorati rajonal i policisë së Mitrovicës dhënë Grupit të Krizave.

⁷² Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave, numër 200, *Integrimi i serbëve në Kosovë: Taking the plunge*, 12 maj, 2009.

⁷³ Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, aneksi III, artikulli 3,4.

⁷⁴ Ibid, artikulli 9.

⁷⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb i Kosovës, Zubin Potok, 30 qershor, 2010.

⁷⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb i Kosovës, Leposaviq, 1 korrik, 2010.

⁷⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb i Kosovës, Zubin Potok, 30 qershor, 2010.

kampus në Serbi dhe vazhdon të rritet. Duke qenë pjesa e vetme urbane e serbëve të Kosovës, gjysma e këtij qyteti është bërë mjaft atraktive si pasojë e benefiteve që i jipen studentëve serbë të Kosovës të cilët vijnë nga enklavat e jugut. Aty gjendet edhe spitali rajonal i cili sfidon edhe spitalet më të mira në Serbi. Institucionet e vetme të Kosovës janë bankat e regjistruara në Prishtinë të cilat operojnë me euro edhe pse dinari serb përdoret më së shumti.

Për ndryshim nga Serbia, në Veri të Kosovës nuk ka prezencë aktive të policisë, përveç njësisë joefikase të Policisë së Kosovës (PK) dhe oficerëve të ministrisë së brendshme serbe (MUP), të veshur në rroba civile. Pasi që PK-ja nuk bashkëpunon me institucionet paralele, sundimi i ligjit është mjaft i vështirë dhe varet kryesisht nga individë qëllimshëm. Oficerët civil të MUP-it nuk janë shumë aktivë dhe më shumë fokusohen në inteligjencë.⁸⁵ Ata as nuk ndjekin kriminelët e as nuk i zbatojnë ligjet lokale. Gjithandë Kosovës, institucionet serbe kanë staf të tepërt dhe fonde të mëdha; Beogradi i kontrollon ato kryesisht përmes inspektorateve relevante të ministrive përkatëse. Hetimet serioze për korrupsion janë të rralla. Rrjedhimisht, edhe pse Veriu është gati tërësisht i shkëputur nga institucionet qendrore në Prishtinë, ai ka një nivel të lartë të autonomisë nga Beogradi, dhe për këtë shumica e konsiderojnë këtë pjesë si një zonë gri në të cilën lulëzojnë aktivitetet ilegale e mbi të gjitha kontrabanda.⁸⁶

Shumë nga përpjekjet për të lidhur Veriun me institucionet e Prishtinës kanë dështuar dhe kanë përfunduar me dhunë. Më 17 mars të 2008-ës, sulmi në gjykatë e cila paraprakisht ishte marrë nga gjyqtarët grevist serbë, rezultoi me vdekjen e një paqeruajtësi të OKB-së. Me rastin e hapjes së zyrës civile të Kosovës në mahallën e Boshnjakëve më 2 korrik 2010, u zhvilluan demonstrata ku u hodh një granatë dore dhe u vra një person dhe 11 të

tjerë u plagosën.⁸⁷ Përpjekjet për të vendosur kontrollin në pikat kufitare 1 dhe 31⁸⁸ janë shoqëruar me kërcënime të dhunshme. Në Veri, mospajtimet tolerohen rallë. Anëtarët e ekipeve të cilat kishin për detyrë të përgatisin zgjedhjet e Kosovës në veri ishin kërcënuar deri në largimin e tyre. Më 4 korrik 2010, një prson i paidentifikuar kishte plagosur Petar Miletiçin, të vetmin deputet nga Mitrovica e Veriut që merr pjesë si deputet në parlamentin e Kosovës. Statusi i pazgjidhur i Veriut rrit presionet nacionaliste në Prishtinë, të cilat, në një të ardhme të afërt, mund ti vënë fajin BE-së dhe EULEX-it për mungesë të progresit.

B. AUTONOMI MË E FUQISHME?

Udhëheqësit e Kosovës kanë filluar të pajtohen me faktin se Veriu i vendit nuk është i njëjtë me enklavat serbe në jug. Në vend të zëvendësimit të komunave “paralele” serbe me komunat zyrtare të Kosovës, Prishtina i ka thënë Grupit të Krizave së është duke shqyrtuar mundësinë e legalizimit të atyre strukturave brenda sistemit të saj. Si shpërblim për “normalizimin” e marrëdhënies me Serbinë, siç janë shkëmbimi i përfaqësuesve diplomatikë dhe mospengimi i pjesëmarrjes së Kosovës në institucione ndërkombëtare, Kosova ka gjasa, që përveç kompetencave edhe ashtu të parapara me planin e Ahtisarit, t’i ofrojë Veriut një komandë të ndarë policore dhe mbajtjen e shumicës së të hyrave nga kufiri verior. Por, Beogradi do të duhej të pranonte që Prishtina ta kontrollojë kufirin verior si dhe ta mbështesë vendosjen e plotë të sistemit të përbashkët gjyqësor dhe të drejtësisë në Veri. Në këmbim të njohjes së plotë nga Serbia dhe vendosjes së marrëdhënies të dyanshme, që do të shoqërohej me mbështetje të plotë të BE-së për integritetin territorial, Kosova do të mund të shkojë edhe më tutje dhe të lejojë që Veriu të zgjedhë parlamentin rajonal me kompetenca të caktuara dhe me mundësinë e krijimit të një ekzekutivi rajonal.⁸⁹

Serbia dhe serbët e Veriut e refuzojnë këtë opsion. Kur Grupi i Krizave përshkroi propozimin e përmendur më lartë për autonomi të zgjeruar, një zyrtar i lartë i ministrisë së jashtme tha se propozimi nuk është asgjë më shumë se “një version i planit të Ahtisarit” marginalisht më i favorshëm. Një tjetër refuzoi autonominë për Veriun, duke thënë se “e kemi provuar një gjë të tillë më

⁸⁵ E vërejtur nga Grupi i Krizave, 2007-2010. Edhe pse rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit ua ndalon forcave serbe të sigurisë punën në Kosovë, oficerë të ministrisë së punëve të brendshme (MUP) janë present në shumicën e pjesëve të banuara me serbë. Ndoshta më se shumti mund të vërehen në Mitrovicën veriore; Grupi i Krizave po ashtu ka vërejtur raste kur zyrtarë të MUP-it kanë dërguar dokumente nga zyra e tyre në mashallën e Boshnjakëve në Beograd, përmes autobusit, zakonisht në mëngjes të vonshëm. Një skandal public u shkaktua në qershor, 2010, kur Dragisha Antic, oficer i feshhtë i MUP-it, të cilit gjatë ikjes nga postblloku i PK-së në veri të Kosovës, i kishte rënë distinktivi i MUP-it. “policia dokumenton prezencën e MPB-së serbe në veri”, *Koha Ditore*, 11 qershor, 2010. Grupi i Krizave poashtu ka vërejtur grupe më pak zyrtare të cilat ruajnë urën e Mitrovicës.

⁸⁶ Në lidhje me kontrabandën dhe veprimtaritë tjera ilegale në veri dhe gjithandë Kosovës, shih reporting e Grupit të Krizave, *Sundimi i ligjit në Kosovën e pavarur*, op. cit.

⁸⁷ Bojana Barlovac, “Një i vdekur, 11 të lënduar në shpërthimin në Mitrovicën veriore”, *Balkan Insight*, 2 korrik, 2010. Ngjarja kishte implikime politike dhe ishte manipuluar si nga Beogradi ashtu edhe nga Prishtina; hetimet e ndërmarra nga PK-ja dhe EULEX-i ende vazhdojnë. Nuk është dhënë asnjë deklaratë në lidhje me identitetin e personave përgjegjës.

⁸⁸ Shih fusnotën 82 më lartë.

⁸⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë qeveritar, Prishtinë, 18 qershor, 2010.

parë në Sllavoninë Lindore dhe nuk ka pasur sukses”.⁹⁰ Një zyrtar i moderuar serb nga Mitrovica Veriore e konsideroi thjesht “autonomi kulturore”, që në kontekstin jugosllav është fjalë tjetër për qytetarë të rendit të dytë dhe ekspozim ndaj fuqisë së shumicës.⁹¹ Kundërshtimet e kryetarit të komunës së Mitrovicës Veriore ndaj planit të Ahtisarit vlejnjë për çfarëdo statusi autonom, pavarësisht nivelit që ajo mund të ketë.

Në anën tjetër, autonomia për Veriun e cila tejkalon planin e Ahtisarit e njohur si “Ahtisari plus” nuk pëlqehet as nga udhëheqësit shqiptarë të Kosovës. Deri vonë, asnjëri nga ta as që do ta konsideronte një zgjidhje të tillë. Një anëtar i opozitës në parlament thotë se “nuk është se nuk më pëlqen plani [juaj]. Unë e urrej atë”.⁹² Presidenti Fatmir Sejdiu dhe kryeministri Hashim Thaçi, të cilët udhëheqin dy partitë më të mëdha parlamentare e kanë refuzuar këtë opsion në mars të vitit 2010.⁹³

Nga ajo kohë, pozita e kryeministrit Thaçi ka evoluar dhe ai tanimë edhe publikisht ka lënë të kuptohet se do të mund të bëhej më shumë për Veriun, duke thënë se “forma të reja të bashkëpunimit të cilat njohin natyrën e veçantë të rajonit të Kosovës veriore duke mbajtur atë pjesë të integruar plotësisht” janë të mundshme.⁹⁴ Vijat e kuqe të qeverisë së Prishtinës janë integriteti territorial dhe statusi. Cështjet tjera mund të diskutohen, përderisa bëhen lëshime nga të dyja anët,⁹⁵ por Prishtina do të pranojë një autonomi të tillë vetëm në këmbim të njohjes nga Serbia.

Trysnia që të shkohet përtej planit të Ahtisarit kur flitet për Veriun, bën që udhëheqësit shqiptarë të Kosovës të kërkojnë shfuqizimin e pjesërishtë apo te plotë të këtij plani.⁹⁶ Një lider opozitar pyeste, “pse duhet të mbajmë të njejtin flamur”, që sinjifikon shtet neutral dhe multietnik në vend të flamurit shqiptar të pëlqyer nga kosovarët, nëse detyrohemi ti japim serbëve në veri të drejta spe-

ciale?⁹⁷ Një zyrtar i lartë i PDK-së thotë se “çkado që shkon përtej planit të Ahtisarit do ta vrasë planin në tërësi”.⁹⁸ Një udhëheqës i i njëjës prej partive në koalicion pohon se serbët janë një nga minoritetet më të privileguara në botë dhe refuzon çfarëdo aranzhimi special për gjykatat dhe policinë në Veri, sepse kjo sipas tij, do ta rrezikonte sovranitetin e shtetit.⁹⁹ Gjatë intervistave, një numër i udhëheqësve të spektrit politik pohojnë se autonomia e zgjeruar do të mund të ishte edhe më e keqe se sa shkëmbimi i territoreve.¹⁰⁰

Shumë observues evropianë rekomandojnë autonomi të zgjeruar. Një diplomat me përvojë disavjeçare në Ballkan beson se kjo është “zgjidhja e vetme” dhe pohon se zbatimi i decentralizimit në Veri sipas planit të Ahtisarit është i “paimagjinueshëm”.¹⁰¹ Kjo ide për momentin përkrahët kryesisht nga ndërkombëtarët. Përkundër kundërshtimit të fuqishëm lokal si dhe armiqësia e pjesëve më të mëdha të elitave në Beograd e Prishtinë, autonomia e zgjeruar mbetet opsion që vlen të shqyrtohet. Duke qenë se është mes ndarjës së përkrahur nga Beogradi dhe planit të Ahtisarit të përfaquar nga Prishtina, qëndrimi ndaj këtij opsioni ka gjasa të ndryshojë.¹⁰²

Asnjë marrëveshje nuk do të mund t’i kënaqë preferencat e serbëve të Veriut për të mbetur jashtë Kosovës dhe mbrojtjen nga Prishtina të integritetit territorial. Mirëpo, një ofertë për autonomi të gjërë do të mund të ishte në pajtim me linjat e kuqe të Prishtinës, duke lejuar në anën tjetër Veriun ta qeverisë veten (sikurse tani), pa interferime dhe me përfshirje të gjërë të Serbisë. Detajet do të duhej të hartoheshin nga palët varësisht nga ajo se sa ka fituar secila në fushat tjera. Por për ti lënë të gjitha palët të kënaqura me rezultatin, autonomia mund të përfshijë pjesën më të madhe apo të gjitha nga pikat në vijim:

⁹⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 16 qershor, 2010. Krahasimi nuk është valid: Sllavonia Lindore ka qenë pjesë e Kroacisë dhe e okupuar nga forcat serbe në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë; në marrëveshjen e Erdutit, më 12 nëntor, 1995, Serbia ishte pajtuar për integrimin paqësor të kësaj pjese në sistemin e Kroacisë, pa status special autonom port ë mbikqyrur nga një administratë tranzitore e OKB-së.

⁹¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë serb i Kosovës, Mitrovicë veriore, 20 janar, 2010.

⁹² Intervistë e Grupit të Krizave, deputet i AAK-së në parlament, Prishtinë, 9 shkurt, 2010.

⁹³ Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, 12 mars, 2010.

⁹⁴ Kryeministri Thaçi, fjalim publik, op. cit.

⁹⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar qeveritar, 23 qershor, 2010.

⁹⁶ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i AAK-së, Prishtinë, 9 qershor, 2010; zyrtar i AAK-së, Prishtinë, 10 qershor, 2010; dhe zyrtar i LDK-së, Prishtinë, 11 qershor, 2010.

⁹⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i AAK-së, 10 qershor, 2010.

⁹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i PDK-së dhe ministër, Prishtinë, 21 qershor, 2010.

⁹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i LDK-së, Prishtinë, 11 qershor, 2010.

¹⁰⁰ Intervista të Grupit të Krizave, ministër i PDK-së; zyrtar i AKR-së; zyrtar i lartë i AAK-së, Prishtinë, qershor-korrik, 2010. Një zyrtar i lartë shqiptar e pershkroi autonominë e zgjeruar për veriun si “një bombë me teledirigjues të kontrolluar nga Beogradi”, intervistë e Grupit të Krizave, Tiranë, 27-28 korrik, 2010.

¹⁰¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i BE-së, Prishtinë, 11 qershor, 2010.

¹⁰² Një diplomat evropian i afërt me politikën e Beogradit i ka thënë Grupit të Krizave se ai beson që Serbia është duke e përdorur ndarjen si “bogey-man” në mënyrë që kërkesat tjera, përfshirë këtu autonominë e zgjeruar të duken më të arsyeshme dhe se synimet e përgjithshme të Serbisë janë ende fleksibile; intervistë e Grupit të Krizave, 11 mars, 2010.

- Veriu do të mund të kishte legjislativin rajonal, me kompetenca të plota rreth çështjeve të ndryshme të sundimit të ligjit dhe për implemetimin e fushave tjera ligjore. Legjislativi do të kishte fuqinë e caktimit të datës për zgjedhje rajonale, që do të mund të ishte e ndryshme nga pjesët tjera të Kosovës. Komisioni qendror i zgjedhjeve i Kosovës do të mbikëqyrte zgjedhjet së bashku me komisionin rajonal të Kosovës Veriore. Legjislativi do të caktonte ekzekutivin rajonal.
- Veriu do të mund të formonte policinë dhe gjykatat lokale me juridiksion civil për krime të lehta; Policia e Kosovës në Veri do të kishte juridiksion vetëm mbi krimet serioze (sikurse trafikimi dhe terorizmi), kurse policia lokale do të obligohej të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës në hetime të përbashkëta, të raportojë rregullisht dhe të japë informata. Policia e Veriut do të mund të bashkëpunonte drejtpërdrejt me policinë serbe, me informimin paraprak të Policisë së Kosovës. Vendimet e gjykatave lokale do të dëgjoheshin nga Gjykata e Kosovës për Ankesa, e cila do të hapte një dhomë të ndarë në Mitrovicën Veriore.
- Veriu do të mund të mbledhte një përqindje të lartë të hyrave doganore nga trafiku në drejtim të Serbisë dhe Malit të Zi dhe të marrë një pjesë të taksave nga fitimi si dhe TVSH-në e mbledhur në rajon e poashtu edhe të gjitha taksat lokale. Gjithashtu, edhe më tej do të mbante të drejtën për fonde shtesë nga Beogradi sic parashihet me planin e Ahtisarit. Veriu do të bëhej pronar i të gjitha pronave shtetërore në territorin e tij të cilat nuk do të jenë të obliguara të përmbushin obligimet shtetërore të Prishtinës. Vetëm asetet me rëndësi nacionale, sic është liqeni i Gazivodës, do të kontrolloheshin nga shteti.
- Serbia dhe Kosova do ta njihnin njëra tjetrën dhe do të pajtoheshin për vendosjen e një kufiri të zbutur (jo vetëm në veri) me ç'rast qytetarët do të mund të udhëtonin vetëm me letërnjoftime.
- Serbia do të pajtohej të pranonte dokumentet dhe kredencialet e Kosovës, me theks të vecantë diplomat universitare (e rëndësishme për të rinjtë në Luginën e Preshevës, të cilëve nuk u njihen diplomat e fituara në Universitetin e Prishtinës). Beogradi po ashtu do t'i jipte më shumë kompetenca Luginës së Preshevës dhe të posaformuarit Keshill Nacional për Minoritetin Shqiptar.¹⁰³

¹⁰³ Këshilli kombëtar është konstituuar në qershor, 2010. Është formuar përmes zgjedhjeve të thejshta dhe ka për qëllim lehtësimin dhe koordinimin e projekteve dhe iniciativave në interes të minoriteteve locale në fushën e arsimit, kulturës, informacionit dhe të drejtën për shfrytëzimin e gjuhës dhe simboleve kombëtare.

C. SHKËMBIM TERRITORESH?

Shumica e diskutimeve në Serbi bëhen rreth shkëmbimit të territoreve.¹⁰⁴ Nuk ekziston gatishmëri që të vendosen marrëdhëniet diplomatike me Kosovën në kufijtë e saj të tanishëm.¹⁰⁵ Zgjidhja e preferuar e Beogradit është ndarja, ku Veriu do t'i kthehej (apo nga këndvështrimi i Beogradit, t'i mbetej) Serbisë, e cila do ta pranonte pjesën tjetër të Kosovës si shtet të pavarur.¹⁰⁶ Duke qenë të vetëdijshëm për reputacionin jo aq të mirë që bart fjala "ndarje", zyrtarët serbë flasin për "një rregullim të brendshëm të kufijve administrativ që do të rezultonte me një kufi të ri të jashtëm".¹⁰⁷

Kosova do ta refuzonte ndarjen e territorit të saj. I vetëdijshëm për këtë, Beogradi, edhe pse ende jo publikisht, ka filluar të luajë me idenë e shkëmbimit të një pjese të madhe të Luginës së Preshevës me veriun e Kosovës, proces ky që do të përcillej me njohje të ndërsjellë. Zyrtarë të lartë mendojnë se nuk është e arsyeshme të lejohet që një copë e vogël e pazhvilluar toke, e banuar kryesisht me shqiptarë, ta fundosë arritjen e një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse rreth problemit kryesor të brendshëm e të jashtëm të Serbisë.¹⁰⁸ Linjat e kuqe të Serbisë në Luginë janë: baza ushtarake Jug [Jugu] në Cepotinë, në jug të qytetit të Bujanocit, autostrada drejt Selanikut e cila kalon përmes Peshevës e Bujanocit si dhe komuna e Medvegjes.¹⁰⁹

Lugina e Preshevës përfshin tri komuna, Preshevën e Bujanocin në jug dhe Medvegjinë e vogël më në veri, me

¹⁰⁴ Aspektet serbe të këtij seksioni bazohen në intervista të shumta në vitet 2009 dhe 2010 me zyrtarë të lartë në ministrinë e jashtme dhe të për Kosovë, të përmbushura nga intervistat me siplomatë të vendosur në Beograd, gazetarë dhe analistë; aspektet e Kosovës bazohen në intervista të shumta me zyrtarët më të lartë qeveritar dhe udhëheqësit opozitar në Prishtinë gjatë periudhës së njejtë.

¹⁰⁵ Një zyrtar i lartë ka thënë se Serbia do mund të këmbente ambasadorë me Kosovën pa ndryshim të kufijve, por vetëm nëse Kosova heq dorë nga anëtarësimi në OKB dhe pajtohet që në OKB të përfaqësohet nga një delegacion i përbashkët; intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, tetor, 2009.

¹⁰⁶ Kushti tjetër i Serbisë për njohjen e Kosovës përfshin Kishën Ortodokse Serbe, të diskutuar në Seksionin IV më poshtë.

¹⁰⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 15 qershor, 2010.

¹⁰⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 15 qershor, 2010.

¹⁰⁹ Intervista të Grupit të Krizave, ministria për Kosovë, Beograd, 15 qershor, 2010. Baza ushtarake është më e madhja në Serbi dhe përfaqëson shpenzimin më të madh capital të suhtrisë qysh nga shpërbërja e Jugosllavisë. Autostrada është pjesë e korridorit trans-evropian numër 10, nga Gdanski deri në Selanik; Serbia shpreson se kjo rrugë do t'i sjellë përfitime të mëdha nga tregtia e Evropës me Turqinë.

Kosovën në mes tyre.¹¹⁰ Shumica e shqiptarëve të Serbisë jetojnë në këtë pjesë, numri i të cilëve sipas regjistrimit të vitit 2002 llogaritet rreth 56,595.¹¹¹ Nga viti 1999 e deri në maj 2001, Ushtria Clirimtare e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës (UCPMB) kishte filluar një kampanjë të rezistencës ndaj pushtetit serb. Për shumë vite, elita e Prishtinës dhe shqiptarët e Luginës e kishin konsideruar këtë zonë si pjesë organike të Kosovës, e cila do t'i bashkohej herët a vonë. Megjithatë, gjatë bisedave rreth planit të Ahtisarit, komuniteti ndërkombëtar ushtroi trysni që Kosova të hiqte dorë nga pretendimet jashtë kufijve të saj.¹¹²

Udhëheqësit shqiptarë të Luginës u pajtuan me realitetin e ri, dhe në vitin 2007 bënë thirrje që shqiptarëve në jug të Serbisë tu jipet një nivel më i lartë i decentralizimit dhe autonomisë territoriale, njësoj sikur ato që Beogradi i kishte kërkuar për serbët në Kosovë, duke shtuar se “në rast të ndryshimit eventual të kufijve të Kosovës, shqiptarët do të punonin për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën”.¹¹³ Si Beogradi që lidh fatin e Kosovës me Veriun, ashtu edhe shqiptarët insistojnë në trajtim të barabartë të Veriut me Luginën. Sikurse nacionalistët serb që e konsiderojnë tërë Kosovën tokë të bekuar, nacionalistët shqiptarë pohojnë se Serbia “nuk ka çka të këmbëjë; si Veriu ashtu edhe Lugina e Preshevës janë të shqiptarëve të Kosovës”.¹¹⁴

Liderët e Kosovës nuk e diskutojnë publikisht mundësinë e ndryshimeve territoriale, duke dashur që të provojnë edhe një herë gjetjen e rrugës për integrimin e serbëve të Veriut. Mirëpo një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve të lartë në nivelin ministror dhe parlamentar, janë të gatshëm ta shqyrtojnë mundësinë e shkëmbimit të Veriut për një pjesë të Luginës.¹¹⁵ Kosova e din se pozita e saj në negociatën varet nga mbështetja e fuqishme nga SHBA-të dhe 22 vendet e BE-së, shumica e të cilave kundërshton

fuqishëm ndërrimin e kufijve; kjo bën që në Prishtinë tema e shkëmbimit të diskutohet me një dozë nervoze. Kjo mënyrë e të menduarit poashtu vjen si pasojë e viteve të tëra të një përvoje të keqe me Beogradin si dhe nga frika e ndonjë mashtrimi nga ana e Serbisë. Megjithatë, një zyrtar thotë se nëse shkëmbimi vihet në tavolinën e bisedimeve, “ne duhet ta marrim atë”.¹¹⁶ Udhëheqësit e Luginës besojnë se është e drejtë e tyre t'i bashkohen Kosovës, por duke ditur pozitën e tyre relativisht të dobët, janë më se të kënaqur që t'i përfaqësojë Prishtina.¹¹⁷ Disa preferojnë që Lugina të mbetet si tërësi autonome në kuadër të Serbisë, kurse shumica do të pajtoheshin me një status të njejtë me atë të serbëve të Veriut.¹¹⁸

Rreth 80 përqind e komunave të Preshevës e Bujanocit shtrihen në perëndim të autostradës, pjesë kjo që duket se Serbia është e gatshme ta këmbëjë. Shumica e popullatës shqiptare gjendet në tri fshatra të mëdha (Tërrnoci i Madh, Rahovica, Rainca dhe Konçuli), ku edhe u formuluan qelizat e para të UCPMB-së. Sipas të gjitha gjasave, qyteti i Bujanocit do të shkaktojë mospajtime të mëdha; numri i shqiptarëve, serbëve dhe romëve është deri diku i barabartë, ndërsa të gjitha partitë shqiptare insistojnë se i tërë qyteti duhet t'i bashkohet Kosovës.¹¹⁹ Serbia duket e gatshme ta ndajë qytetin, sikurse në rastin e veriut dhe jugut të Mitrovicës.¹²⁰ Me këtë rast, disa mijëra shqiptarë se bashku me 1,816 që jetojnë në Medvegjë, do të mbeteshin në pjesën serbe të kufirit.

Nëqoftëse Prishtina shqyrton mundësinë e shkëmbimit, linjat e saj të kuqe sipas të gjitha gjasave do të ishin Liqeni i Gazivodës, që do të formohej nga penda në lumin Ibër në komunën e Zubin Potokut. Gazivoda është burimi kryesor i ujit për veriun e Kosovës, prandaj prodhuesit e eneregjisë elektrike që shfrytëzojnë qymyrin si lëndë të parë e të cilat furnizojnë kryeqytetin e Kosovës nuk mund të funksionojnë pa te. Një zyrtar i lartë phon se “Presheva është çështje emocionale, [por] Gazivoda është çështje vitale për jetërat e një milion njerëzve”.¹²¹ Një udhëheqës i opozitës pohoi se liqeni është “çështje ekzistenciale” për Kosovën, sepse humbja e tij do ta rrezikonte mbijetesën e saj.¹²² Duke qenë për vete e furnizuar mirë me burime

¹¹⁰ Për më shumë informata, shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave, numër 116, *Paqja në Preshevë: Ndrejje e shpejtë apo zgjidhje permanente*, 10 gusht, 2001; dhe numër 152, *Paqja e brishtë e Serbisë jugore*, 9 dhjetor, 2003.

¹¹¹ Ky numër mund të jetë më i vogël, pasi që shumë shqiptarë të Preshevës punojnë jashtë; paratë që sjellin (remitancat) janë një burim i rëndësishëm i të hyrave për ata që janë në këtë pjesë të varfër.

¹¹² Ekipi i Unitetit i Kosovës i shihte serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Serbisë si një urë për marrëdhënie të mira mes dy shteteve; intervista të Grupit të krizave, anëtarët e Ekipit të Unitetit, prill-maj, 2006; raporti I Grupit të Krizave, *Kosova: Pa ndonje zgjidhje alternative kundër planit të Ahtisarit*, op. cit.

¹¹³ “Platforma Politike e Këshilltarëve Shqiptarë të Luginës”, Preshevë, 14 janar, 2006.

¹¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar komunal shqiptar, Bujanoc, 29 qershor, 2010.

¹¹⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të PDK-së dhe LDK-së, qershor, 2010.

¹¹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar qeveritar, Prishtinë, 5 korrik, 2010.

¹¹⁷ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë komunal shqiptarë, Preshevë, bujanoc, 28-29 qershor, 2010.

¹¹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, udhëheqës shqiptar, Preshevë, 28 qershor, 2010.

¹¹⁹ Intervista të Grupit të Krizave, liderët e partive shqiptare, Bujanoc, 29 qershor, 2010.

¹²⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 21 korrik, 2010.

¹²¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë së Kosovës; ish-kryeministër i Kosovës, Prishtinë, 23 qershor, 2010.

¹²² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i AAK-së, Prishtinë, 9 qershor, 2010.

ujore, Serbia ndoshta nuk do t'i vlerësojë sa duhet brengat që Gazivoda i sjell Kosovës. Vendosija e kufirit përgjatë liqenit do t'i garantonte Kosovës qasje në të; për më shumë, të drejtat mbi ujën do të mund të futeshin në një marrëveshje bilaterale.¹²³

Nëse nuk gjendet zgjidhja për Veriun, Prishtina do të mund të vepronte njëkohshëm në Preshevë. Një ministër në qeveri thotë se për momentin, komunitatet e Veriut refuzojnë të shpenzojnë paratë e ndara nga Prishtina, dhe sipas tij, këto para do të mund t'i jipeshin shqiptarëve në Preshevë; Kosova ka të gjitha aftësitë që të investojë në Luginë po aq pak sa edhe Beogradi.¹²⁴ Sipas kësaj, nuk do të ishte larg mendsh që të shohim formimin e institucioneve paralele dhe ringjalljen e konfliktit të shkallës së ulët që tronditi Luginën në periudhën 1999-2001.

Ndeshimet territoriale ishin përjashtuar nga plani i Ahtisarit si dhe nga principet e Grupit të Kontaktit.¹²⁵ Grupi i Krizave vazhdimisht ka tërhequr vërejtjen për rrezikun e ndarjes, duke u bazuar në implikimet që diçka e tillë do të mund të kishte në rajon, si dhe në serbët e shumtë që jetojnë në jug të Ibrit. Tani që opsioni i shkëmbimit të territoreve është, nëse jo në tavolinë, atëherë në karrigën e njerës palë¹²⁶ (citat i negociatave në Qipro rreth planit të Annanit), argumentet kundër shkëmbimit të territoreve duhet të rishqyrtohen dhe të shihen në kuadër të të mirave që sjell zgjidhja mes Kosovës e Serbisë.

1. Implikimet për rajonin

Shumica kanë frikë se shkëmbimi i territoreve do ta destabilizonte rajonin, duke provokuar tensione etnike në Maqedoni apo duke inkurajuar ndarjen e Republika

Srpska-s.¹²⁷ Gati të gjithë udhëheqësit e shqiptarëve të Kosovës të cilët kundërshtojnë ndërrimin e kufijve përmendin këtë argument.¹²⁸ Në vitin 2007, Grupi i Krizave kishte paralajmëruar se “shqiptarët e Maqedonisë...do të mund të vinin në dyshim për herë të dytë rregullimin shtetëror dhe të fillojnë ta shohin Tetovën si ‘kapitolin’ e jugut të Kosovës”.¹²⁹ Por, intervistat e fundit, kanë dhënë shenja të qarta se në mesin e liderëve shqiptarë të Maqedonisë nuk ekziston gatishmëri për një lëvizje të tillë.

Neogociatat mes Prishtinës e Beogradit do të tensiononin marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni, ku minoriteti i madh shqiptar kishte luftuar për një kohë të shkurtër më 2001, luftë kjo që u përfundua me marrëveshjen e Ohrit për ndarjen e kompetencave.¹³⁰ Mirëpo, edhe në ballafaqim me idenë për ndarjen e Kosovës, janë të paktë liderët shqiptarë në Maqedoni të cilët avokojnë për ndarje nga Maqedonia. Në vitin 2001, ish-kryeministri i Serbisë, Zoran Gjingjiq u kishte propozuar liderit maqedonas Ljupco Georgievski dhe atij shqiptar Arben Xhaferi ndarjen në të njëjtën kohë të Kosovës dhe Maqedonisë. Por kjo ide u shua kur shqiptarët kuptuan se sipas këtij plani, gati gjysma e tyre do të mbeteshin në anën e gabuar të kufirit.¹³¹

Shumë shqiptarë jetojnë në Shkup dhe paralagjet e tij dhe në pjesë të tjera të cilat maqedonasit shumicë nuk do t'i lëshonin. Udhëheqësit e shqiptarëve të Maqedonisë kanë dhënë arsye të fuqishme për atë se pse një ndarje e tillë “nuk ka qenë në interesin nacional të shqiptarëve” dhe pse një plan i tillë është më i levërdishëm për nacionalistët maqedonas që kërkojnë shtet etnik.¹³² Në mes tjerash, sipas tyre, ndarja do të mund të çonte drejt shpërndarjes së Maqedonisë mes Bullgarisë, Greqisë dhe Ser-

¹²³ Fshatrat në jug të liqenit në Zubin Potok janë: Brnjaki, Dragaljica, jabuka, Preseka, Mala Kaludra, Velika Kaludra, Gornji Jasenoviku dhe Donji Jasenoviku. Këto fshatra janë etnikisht serbe dhe edhe pse të vogla dhe të izoluara, prej shumicës prej tyre mund të shihet qyteza e Zubin Potokut.

¹²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar qeveritar, prishtinë, 2 korrik, 2010.

¹²⁵ Grupi i Kontaktit (Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Britania e Madhe dhe SHBA-ja) hartuan dhjetë principe për ti dhënë drejtim procesit të statusit final, duke përfshirë “mosndryshimin e territorit të tanishëm të Kosovës, të mos ketë ndarje të Kosovës apo bashkim me çfarëdo shteti apo pjesë të çfarëdo shteti tjetër”. “Principet duhezuese të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës”, 7 tetor, 2005. Megjithatë, këto principe nuk përjashtojnë marrëveshjet bilaterale për shkëmbim territorësh, të cilat nuk do të ishin as ndarje e as bashkim i Kosovës me ndonjë shtet tjetër.

¹²⁶ Lideri turko-qipriot, Mehmet ali Talat i cituar nga Fatma Demireli, “Talat tërhiq vërejtjen se tensioned e brendshme në Turqi do ta demtojnë rastin e Qipros”, *Today's Zaman*, 4 prill, 2008.

¹²⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat i BE-së, Paris, 5 korrik, 2010.

¹²⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të AAK-së, Prishtinë, 9-10 qershor; zyrtar i LDK-së, 11 qershor, 2010; zyrtar i lartë qeveritar, Prishtinë, 18 qershor, 2010; dhe zyrtarë tjerë të partive në Kosovë, prishtinë, 23 qershor dhe 14 korrik, 2010.

¹²⁹ Raporti i Grupit të Krizave, *Numërimi i ditëve i Kosovës*, op. cit., fq. 5.

¹³⁰ Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave, numër 23, *Maqedonia: Duke mbushur vakuumin e sigurisë*, 8 shtator, 2001; dhe numër 21, *Maqedonia: Lufta në prag*, 15 gusht, 2001.

¹³¹ Thuhet se raporti ka paraparë vendosjen e Tetovës dhe Gostivarit në kufi me Shqipërinë dhe pjesë të Komanovës në veri; rreth 250,000 shqiptarë dhe 60,000 maqedonas do të duhej të zhvendoseshin. Intervistë e Grupit të Krizave, politikan shqiptar i Maqedonisë, Tetovë, 8 korrik, 2010.

¹³² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar shqiptar i qeverisë së Maqedonisë, Shkup, 8 korrik, 2010.

bisë, ku shqiptarët do të mbeteshin minoritete të vogla në shtete të mëdha.¹³³

Një zyrtar i lartë maqedonas pranon se shkëmbimi territorial mes Kosovës e Serbisë do të mund të “zgjonte apetitet”, por sipas tij, Bosnja do të rrezikohej më shumë. Duke folur me argumentet e liderëve shqiptarë, ai thotë se “ekstremistët” e pidentifikuar dhe jo aq të fuqishëm do të mund të fuqizoheshin, por e konsideron rrezikun “jo si parashikim [të tensioneve] apo probabilitet; është mundësi” që varet nga ajo se sa janë të mbështetur “ekstremistët” nga palët e involvuara.¹³⁴ Kolegu i tij shqiptar thotë se nuk ka vërejtur asnjë shenjë se partia më e madhe maqedonase, VMRO-DPMNE, mbështet ndarjen e vendit.¹³⁵

Të gjithë të intervistuarit nga Grupi i Krizave pajtohen se kërcënimi më i madh për stabilitetin e Maqedonisë vjen nga mosmarrëveshja e vazhdueshme me Greqinë rreth emrit, e cila ka bllokuar anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe ka penguar fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, tash e dy vite.¹³⁶ Shqiptarët e Maqedonisë dëshirojnë integrimin sa më të shpejtë të shtetit të tyre në instancat euro-atlantike. Një lider i opozitës dhe ish-kryeministër e thotë troç: çështja e emrit duhet të zgjidhet “jo sot, por dje” sepse vetëm kjo – heqja e bllokadës për anëtarësim në NATO – do të siguronte stabilitetin shtetëror.¹³⁷ Ndarja ka të bëjë shumë pak me frustrimet e shqiptarëve të Maqedonisë, të cilët ndihen të zënë në kurth nga një shtet i cili nuk po shënon progres, përderisa Shqipëria fqinje tashmë i është bashkuar NATO-s, kurse edhe Kosova duket se ka një të ardhme më të qartë.¹³⁸

Sipas një zyrtari të lartë të BE-së në Shkup, hapja e çështjes së kufirit Kosovë-Serbi gjatë kohës kur Maqedonia është duke pritur në derën e NATO-s do ta ekspozonte vendin ndaj rreziqeve serioze.¹³⁹ Anëtarësimi do t'i jipte Maqedonisë ndjenjën e sigurisë, duke përfshirë prezencën institucionale të SHBA-së; në çfarëdo rasti, anëtarësimi në BE do të marrë më shumë kohë, por fillimi

i negociatave për anëtarësim do të krijonte ndjenjën e progresit dhe shpresës. Në këto rrethana, çfarëdo marrëveshje mes Kosovës e Serbisë do të ishte më lehtë e menaxhueshme. Në anën tjetër, nëse pengesa greke vazhdon edhe më tej, faktorët ndërkombëtarë do të ballafaqoheshin me një zgjedhje të rëndë: krijimi i pengesave për zgjidhjen e konfliktit Kosovë-Serbi apo destabilizimi i Maqedonisë.

Padysim se stabiliteti i Maqedonisë gjithashtu varet shumë nga marrëdhëniet në mes të komunitetit maqedonas e atij shqiptar dhe nga zhvillimi i kulturës politike.¹⁴⁰ Marrëveshja e Ohrit, e cila i dha fund konfliktit të vitit 2001 vazhdon të mos implementohet tërësisht, sidomos në pjesët që merren me gjuhën dhe decentralizimin. Shqiptarët, në anën tjetër, urrejnë këtë gjendje ku sipas tyre alokimi i resurseve në pjesët ku ata janë shumicë është i pabarabartë, ndërsa ende ekziston tendenca që shqiptarëve t'u jipen vende pune me pagat më të vogla.¹⁴¹ Të gjitha palët, Shkupi, Arthina dhe partnerët e tyre ndërkombëtarë, do të duhej të dyfishonin përpjekjet për implementimin e plotë të marrëveshjes së Ohrit, për zgjidhjen e çështjes së emrit dhe zhbllokimin e rrugës së Maqedonisë drejt NATO-s dhe BE-së. Përveç arsyeve të ndryshme për ta bërë këtë, vonesat e tanishme do të fundosnin përfundimisht mundësinë për të tejkaluar mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi dhe do të shtyenin për shumë vite shpresat për anëtarësim të së paku tri vendeve.

Bosnja e Hercegovina është në krizë por ka pak gjasa që të rrezikohet nga marrëveshja Kosovë-Serbi. Opinioni i GJND-së, edhe pse i shkruar me kujdes që ti përshtatet situatës unike në Kosovë, megjithatë nga një lider partie është cituar si “bazë e mirë për secesionin” e Republika Srpska-s (RS); një tjetër udhëheqës, më i moderuar, ka shprehur bindjen e tij se opinioni do të ketë ndikim të fuqishëm në shtetin e tij.¹⁴² Por deklarata si këto shumë shpejtë u venitën duke bërë të ditur se kanë qenë jo më shumë se retorikë e fushatës parazgjedhore. Kryeministri i RS-së, Millorad Dodik, i cili shpesh kishte spekuluar rreth shpalljes së mundshme të pavarësisë nga Bosnja, kësaj radhe ka qenë më i përmbajtur. RS-ja “ende ka durim të punojë me strukturën e Dejtonit” dhe e di se “veprimet e njëanshme nuk mund të prodhojnë zgjidhje të mjaftueshme apo ideale”, ka thënë Dodik, dhe ka rikuj-

¹³³ Intervista të Grupit të Krizave, politikan shqiptar i Maqedonisë, Tetovë, 8 korrik, 2010; zyrtar shqiptar i qeverisë së Maqedonisë, Shkup, 8 korrik, 2010.

¹³⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Shkup, 7 korrik, 2010.

¹³⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar shqiptar i qeverisë së Maqedonisë, Shkup, 8 korrik, 2010. VMRO-DPMNE është shkurtesa për Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar.

¹³⁶ Njoftimi për Evropë i Grupit të Krizave, numër 52, *Emri i Maqedonisë: Thyerja e bllokadës*, 12 janar, 2009.

¹³⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, politikan maqedonas, Shkup, 7 korrik, 2010.

¹³⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë shqiptar i Maqedonisë, Tetovë, 8 korrik, 2010.

¹³⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i BE-së, Shkup, 7 korrik, 2010.

¹⁴⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, diplomat amerikan, Shkup, 7 korrik, 2010.

¹⁴¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë shqiptar i Maqedonisë, Tetovë, 8 korrik, 2010.

¹⁴² “Pavic: Dobra predloga za otcpljenje RS od BiH” [Pavic: Bazë e mirë për ndarjen e RS-së nga BeH], *Vijesti.ba*, 22 korrik, 2010 (online). “Ivanic: Deklaracija o proglašenju nezavisnosti Kosova doprinos jacanju separatizma” [Ivanic: Deklarata e pavarësisë së Kosovës kontribuon në forcimin e separatizmit], *Ljiljan.ba*, 23 korrik, 2010 (online).

tuar se Republika Turke e Qipros Veriore ka dështuar në përpjekjet për të fituar mbështetjen ndërkombëtare.¹⁴³

Serbia ka përkrahur fuqishëm integritetin territorial të Bosnjes, pjesërisht për tu dhënë kredibilitet argumenteve të saja në rastin e Kosovës. Cfarëdo marrëveshje gjithëpërfshirëse që përfshin njohje të ndërsjellë mes Serbisë e Kosovës, qoftë kjo shkëmbimi i territoreve, autonomia e zgjeruar apo modele tjera, do t'i jipte Bosnjes një shembull konstruktiv ku dy armiq të përbetuar tejkalojnë ndasitë përmes kompromisit. Por nëse negociatat dështojnë, Serbia do të mund ta zbuste qëndrimin e saj kundër ndarjes së RS-së. Në rastin më të keq, koalicioni i krahut radikal do të mund t'i fitonte zgjedhjet e vitit 2012 dhe të ripërtrijë idetë e vjetra për pavarësinë apo bashkimin e RS-së me Serbinë, si dëshmipërblim për humbjen e Kosovës.

Grupi i Krizave, në vitin 2005, kishte tërhequr vërejtjen se kur bëhet fjalë për Ballkanin Perëndimor, ndarja e Kosovës do të "shkatërronte levat për transformim pozitiv social, ato të mosdiskriminimit, multietnicitetit e vlerave evropiane, dhe poashtu do të rrezikonte kthimin prapa të procesit, duke i dhënë kështu primatin zgjidhjes përmes shkëmbimit të popullsisë."¹⁴⁴ Në vitet e fundit, Kosova ka miratuar planin e Ahtisarit dhe ka futur këto vlera në rendin e saj kushtetues. Integrimi i vazhdueshëm i enklavave serbe në jug ka përmirësuar multietnicitetin. Por një gjë e tillë nuk ka ndodhur në veri të Ibrit, kryesisht falë mosangazhimit të bashkësisë ndërkombëtare. Grupi i Krizave ka paralajmëruar se Veriu "nuk do të integrohej në Kosovë as lehtë e as shpejtë, apo ndoshta kurrë dhe se "komuniteti ndërkombëtar do të duhej të investonte shumë në siguri, ekonomi e administratë; [por] nuk është i gatshëm ta bëjë këtë".¹⁴⁵ Ky gjykim duket të ketë qenë i drejtë; EULEX-i nuk vërehet në Veri, statusi i tij i pazgjidhur është duke larguar edhe më tepër komunitetet nga njëritjetri dhe është duke futur Prishtinën e Beogradin në drejtimin e diskurseve nacionaliste.

2. Implikimet për jugun

Zgjerimi i autonomisë për Veriun apo shkëmbimi i Veriut me Preshevën do të tendoste pozitën e serbëve në jug të Kosovës që përbëjnë afërsisht dy të tretat e serbëve të Kosovës, e të cilët janë të ndikuar nga procesi i decentralizimit.¹⁴⁶ Qysh prej zgjedhjeve lokale në nëntor 2009,

janë formuar katër komuna të reja me shumicë serbe (Ranillugu, Parteshi, Kllokoti, Graqanica), njëra është zgjeruar (Novobërda) ndërsa njëra ka zgjedhur përfaqësuesit legjitimë (Shtërpca). Suksesi i tyre variron. Autoritetet lokale në Graqanicë dhe Shtërpce, që të dyja me numër relativisht të madh të popullsisë dhe me pak përvojë në qeverisjen komunale, operojnë me kapacitete të plota. Konflikti i mundshëm me komunat paralele të financuara nga Beogradi është evituar në masë të madhe.¹⁴⁷

Komunat më të vogla, sic janë Ranillugu dhe Kllokoti, ballafaqohen me probleme për plotësimin e pozitave menaxhuese si pasojë e mungesës së infrastrukturës, zyrtarëve të papërvojë dhe fondeve të pamjaftueshme. Hasmëria e tyre me strukturat komunale paralele është e thellë dhe përçarëse.¹⁴⁸ Novobërda është në pritje të zgjerimit edhe zyrtarisht, pasi që shumica e serbëve kishin bojkotuar zgjedhjet dhe kryetari i zgjedhur shqiptar nuk është shumë i interesuar për zgjerimin e kufijve në përputhje me planin e Ahtisarit. Zyrtarët serbë të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe kanë fituar ulëse në zgjedhjet komunale të Novobërdës, poashtu kanë fituar ulëse me pjesëmarrje në zgjedhjet paralele të Serbisë, në maj 2010.

Në të kaluarën, Grupi i Krizave dhe të tjerët kishin parashikuar se çfarëdo ndryshimi territorial do të kishte efekt të menjëhershëm në serbët e Kosovës. Ky parashikim bazohej në frikën se do të mund të përsëritej një eksodus i njëjtë si ai i serbëve nga Sarajeva pas marrëveshjes së Dejtonit, e cila i dha fund luftës në Bosnje. Argumente të tilla përdoren shpesh nga elita politike e serbëve të Kosovës, përfshirë këtu Rada Trajkoviqin¹⁴⁹ dhe Rangjell Nojkiqin.¹⁵⁰ Megjithatë, banorët e enklavave serbe thonë se do të qëndrojnë në vendet e tyre për aq sa mund të kenë

Ibrit, kryesisht në pjesët qendrore dhe lindore të Kosovës, op. cit.; "Q&A: E ardhmja e Kosovës", BBC Neës, www.bbc.co.uk/news/world-europe-10725744

¹⁴⁷ Në Shtërpce, ndërtesa e komunës ishte marrë nën kontrollin e qeverisë locale legjitime gjatë ditëve të pushimit. Qeveria paralele protestoi zëshëm, por nuk kishte demonstratë. Në fakt, komuna paralele tashmë kishte zgjedhur lokacionin alternativ. Në Graqanicë, autoritetet e reja komunale u vendosën në një motel, dhe nuk kishte tensione me strukturat paralele.

¹⁴⁸ Për shembull, kryetari i Ranillugut, Gradimit Mikic i kishte vendosur strukturat e reja komunale në fshatin e tij në Ropotovo, pasi që strukturat paralele nuk e lejojnë të hyjnë në Ranillug. Kjo ndarje mes fshatrave reflektohet jo vetëm në ato vende ku politikanët local mund të shkojnë lirshëm por edhe në atë se si alokohen fondet pasi që të dy palët fokusohen vetëm në zonat "lojale". Komuna e Kllokotit është duke u bojkotuar nga një fshat i madh serb Vrbovec, jo vetëm për shkak të infrastrukturës që bën që 10 kilometra të duken shumë të gjata, por edhe për shkak se ky fshat është pjesë e strukturave paralele serbe.

¹⁴⁹ "Beograd kod Obame lobira za podelu" [Beogradi lobon për ndarje të Obama], *Press*, 29 maj, 2010.

¹⁵⁰ "Podelu Kosove zagovaraju Srbi a ne stranci" [Ndarja përmendet nga serbët, jo nga të huajt], *Blic*, 4 gusht, 2010.

¹⁴³ "Dodik: misljenje MSP razocaravajuće" [Dodik: Mendimi I GJND-së dëshpërues], *Nezavisne novine*, 22 korrik, 2010 (online).

¹⁴⁴ Raporti I Grupit të Krizave, Kosova: Drejt statusit final, op. cit., fq. 28.

¹⁴⁵ Ibid, fq. 19.

¹⁴⁶ Për shkak të mungesës së regjistrimit, shënimet mbi popullsinë nuk janë të sakta, por sipas përlogaritjeve, gjysma e deri dy të tretat e serbëve të Kosovës jetojnë në shpërndarë në jug të

“jetë normale”.¹⁵¹ Madje edhe zyrtarët e strukturave paralele pohojnë se “ata të cilët kanë dashur të ikin tashmë e kanë bërë këtë” dhe se “serbët nuk do të lëvizin përveç nëse detyrohen me dhunë”.¹⁵²

Popullata serbe e Kosovës ka gjasa të zvogëlohet por kjo nuk është pasojë e çështjes së statusit. Popullata serbe është e vjetër në moshë dhe kryesisht rurale. Përderisa dikur, bujqësia ishte diçka që të gjitha familjet e bënin si punë dytësore, tani ajo ka mbetur mundësia e vetme.¹⁵³ Që nga viti 1999, Serbia ka dhënë paga të majme për të mbajtur sa më shumë njerëz të punësuar. Por shumë prej atyre që punojnë në Kosovë kanë shtëpitë e tyre në Serbi. Për shembull, rreth gjysma e punëtorëve të sistemit shkollor të Ranillugut, udhëtojnë çdo ditë nga Serbia, sic bëjnë rreth një e treta e atyre që punojnë në qendra të vogla mjekësore. “Më shumë se 80 përqind” e stafit në qendra të mëdha mjekësore në Graçanicë punon në “baza 15-15” – një natë aty e një nate pushim, në Serbi.¹⁵⁴ Me heqjen e këtyre benefiteve, ka gjasa që ata të largohen në Serbi, ku kanë pronat dhe familjet e tyre. Është fakt i ditur se të gjithë udhëheqësit kryesorë serbë të Kosovës i akomodojnë familjet e tyre në Serbi, përfshirë këtu edhe zyrtarët më të lartë nga Partia e Pavarur Liberale (SLS), të cilët janë pjesë e qeverisë së Kosovës.

E ardhmja e këtyre enklavave rrezikohet gjithashtu edhe nga numri i madh i të rinjëve që largohen çdo vit. Investimet serbe në universitetin e Mitrovicës bëjnë që studentët serbë nga jugu i Ibrit të kenë shkollim dhe akomodim falas. Nga 1,627 vende për studentë të vitit të parë më 2010, “dy të tretat do të rezervohen për studentët nga enklavat”.¹⁵⁵ Me t’u larguar nga enklavat, vetëm një numër i kufizuar kanë motiv për tu kthyer; në vend të kësaj, ata hidhen në kërkim të punës në qytete më të mëdha serbe sic është Nishi. Edhe pse jo i ndryshëm nga ai i të rinjëve gjithandej Kosovës, trendi i migrimit drejt Mitrovicës rrezikon zvogëlimin e enklavave në jug të Ibrit.

Megjithatë, këto zhvillime kanë të bëjnë shumë pak me statusin e Kosovës. Serbët e Kosovës për rreth një dekadë kanë filluar të migrojnë dhe të blejnë prona në Serbi. Autonomia e zgjeruar apo shkembimi i territoreve vështirë se do të ndryshojnë diçka. Disa enklava relativisht të mëdha si Shtërpca dhe Graçanica do të mund të mbijetojnë si komuna funksionale. Megjithatë, pjesa më e madhe e enklavave do ta kenë vështirë, me apo pa status të komunës. Ajo çka u nevojitet serbëve në këto pjesë të vogla, rurale e të pazhvilluara është e drejta për të jetuar e punuar tokën e tyre të qetë; sulmet si ai mbi te kthyerit në Zallc, në mars 2010, bën që serbët të jenë tejet skeptikë.¹⁵⁶ Siguria dhe të drejtat themelore janë të rëndësishme, por projektet ambicioze të decentralizimit ndoshta do të duhej të rishqyrtoheshin duke marrë parasysh problemet e vërteta në këto enklava.

Përfundisht, shkëmbimi i Veriut me Luginën e Preshevës, i ndërmarrë nga Kosova e Serbia si partnerë të barabartë, nuk do të favorizonte asnjërin palë. Zgjidhja e tillë do të mund të shihej si kontratë mes dy shteteve sovraane, me kusht që Serbia paraprakisht ta njohë pavarësinë e Kosovës, së paku në mënyrë implicite. Në të njëjtën mënyrë, banorët e Veriut dhe ata të Luginës do të kërkonin që të dëgjohej zëri i tyre rreth kësaj çështjeje, përmes shprehjes së lirë të vetëvendosjes, edhe nëse preferencat e tyre duken më se të qarta.

¹⁵¹ Intervistë telefonike e Grupit të Krizave, gazetar serb i Kosovës, Graçanicë, 5 gusht, 2010.

¹⁵² Intervista telefonike të Grupit të Krizave, zyrtar serb i Kosovës, Shërpce, 4 gusht, 2010; gazetar serb i Kosovës, Shtërpce, 5 gusht, 2010.

¹⁵³ Kolapsi i fabrikave të kohës së socializmit ka dëmtuar Kosovën, me theks të vacantë pjesën lindore, ku gjendet numri më i madh i komunave të reja. Gjatë kohës së socializmit, zona përreth Gjilanit ka qenë pjesë e një rrypi të gjërë të fabrikave të cilat shkonin deri në Vranje dhe Leskovc. Fabrikat e mëdha, sikurse se ajo e baterive në Gjilan, ishin punëdhënësit kryesor në këtë pjesë, por u dëshmuar se nuk mund ta mbanin vethten, duke lënë kështu këtë zonë me një të ardhme të paqartë ekonomike.

¹⁵⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 16 korrik, 2010.

¹⁵⁵ Ibid.

¹⁵⁶ 26 familje si dhe individë (përfaqësues të familjeve të tyre) u kthyen spontanisht në fshatin Zallc në Kosovën perëndimore në mars, 2010. Fillimisht ishte thënë se është propagandë, por këto akuza u menjuan ndërkaq ata u vizituan nga ministrant e Serbisë e Kosovës, si dhe nga zyrtarë ndërkombëtar. Duke shpresuar që mund t’i nxisin donatorët, te kthyerit janë duke jetuar në tenda të dhëna nga UNHCR. Shqiptarët e fshatrave përreth anë thënë vazhdimisht se në mesin e të kthyerve ka edhe kriminelë luftë; në anën tjetër, serbët thonë se kjo po bëhet për ta larguar vëmendjen nga uzurpimet e tokave serbe nga shqiptarët. Qysh nga marsi, 2010, ka pasur sulme të shumta duke përfshirë edhe të shtëna me armë.

IV. ÇËSHTJET TJERA

A. KISHA ORTODOKSE SERBE

Çdo përpjekje për të vendosur një marrëdhënie funksionale duhet të marrë në konsideratë pozitën e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Disa nga strukturat më të vjetra dhe më me rëndësi historike fetare serbe janë në Kosovë dhe përbëjnë një pjesë kyçe të lidhjes emocionale me Kosovën, lidhje kjo që shpesh ka ndikuar në politikat e shtetit serb.

Statusi i Kishës dhe vendeve të shenjta e ka të paktën të njëjtën rëndësi për Serbinë si Veriu sepse vë në diskutim tërheqjen e pretendimeve serbe ndaj Kosovës. Sipas buri-meve të Kishës, kosovarët kanë kryer me shumë se 150 akte vandalizmi ndaj pronave të saj që nga viti 1999.¹⁵⁷ Gjatë protestave të 17 Marsit, 2004, Deviçi mesjetar (Skenderaj) dhe Engujt e Shenjtë (Prizren) janë djegur tërësisht ndërsa Bogorodica Ljeviska (Prizren) është dëmtuar rëndë.¹⁵⁸

Kjo e ka bërë mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe një çështje kyçe gjatë negociatave të mëhershme. Aneksi 5 i planit Ahtisaari¹⁵⁹ merret hollësisht me këto vendndodhje dhe është përfshirë në Kushtetutën e Kosovës.¹⁶⁰ Ky aneks e konfirmon karakterin serb të kishave dhe manastireve duke e kufizuar rëndë qasjen e institucioneve të Kosovës, duke i dhënë Kishës kontrollin mbi qasjen, duke ndaluar shpronësimin dhe duke vendosur zona të veçanta të mbrojtjes.¹⁶¹ Pa marrë parasysh mospranimin e planit të Ahtisarit si të tillë, Beogradi e mbështet gati tërësisht Aneksin 5.¹⁶² Anëtarëe e spikatur të Kishës i kanë përshkruar masat si “90 deri 99 përqind të asaj se çfarë donte Kisha”.¹⁶³ Sidoqoftë, mospranimi i Këshillit të Sigurimit për të adoptuar planin Ahtisaari do të thotë që Aneksit 5 i mungon autoriteti i ligjit ndërkombëtar. Qeveria Serbe do të donte të zgjeronte Aneksin për të siguruar eksterritorialitetin e disa vendeve kyçe fetare dhe të sigurohej që ato të kenë garanci ndërkomb-

bëtare për mbrojtje. Ndërsa një marrëveshje mund të bazohet në Aneksin 5, kjo marrëveshje do të duhej të ripaktohej për të mënjeluar lidhje të drejta me procesin Ahtisaari. Aneksi 5 kërkon mbrojtje ndërkombëtare për kishat dhe manastiret për këtë fazë por parashikon një transfer eventual të këtyre detyrave te policia dhe shërbimet e sigurimit të Kosovës.¹⁶⁴

Beogradi dhe Kisha insistojnë për mbrojtje të vazhdueshme ndërkombëtare,¹⁶⁵ duke u brengosur se me përfundimin e periudhës së tranzicionit nuk do të kishte shumë faktorë që do të ndalonin amandamentimin e kushtetutës të Kosovës ose zbutjen e zbatimit të Aneksit 5.¹⁶⁶ Zyrtarë të Kishës kërkojnë një forcë pak a shumë si ajo e Gardës Zvicerane të Vatikanit – qytetarë të një kombësie të tretë me prani simbolike dhe aftësi mbrojtëse reale.¹⁶⁷ Mandati i një force që do të merrte përgjegjësi graduale nga misioni i NATO-s (KFOR) gjithnjë në zvogëlim do të duhej të përfshihej në një traktat midis Serbisë dhe Kosovës që do të modifikohej me pëlqimin e Kishës.

Eksterritorialiteti në këtë kontekst do të nënkuptonte diçka si statusi i Malit Athos në Greqi ose Pamjes së Shenjtë në Itali.¹⁶⁸ Një verzion i bazuar në një studim nga OJQ-ja greke “ELIAMEP” parasheh që disa vendodhje kyçe të kishës të bëhen vetëqeverisëse si një “Komuniteti Manastiror i Ortodoksëve Serbë” me “ushtrimin e juridiksionit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor” bazuar në ligje dhe zakone të Kishës.¹⁶⁹ Një grup i zgjedhur i murgjëve do të ishte përgjegjës për bashkëveprimin e përditshëm me autoritetet kosovare. Kjo do të ishte më pak se eksterritorialiteti i plotë dhe të kërkonte ndryshime të vogla praktike nga Aneksi 5. Sidoqoftë, Serbia kërkon status të eksterritorialitetit të plotë për gjashtë ose shtatë manastiret më të rëndësishme. Sipas një zyrtari Serb, “nëse ne arrijmë një marrëveshje përgjatë këtyre kornizave, ne natyrisht do të asgjësonim pretendimin për

¹⁵⁷ “Shkatërrimi i kishave dhe mianastireve ortodokse serbe, dioqezës së Rashkës dhe Prizrenit”, www.kosovo.net/default2.html.

¹⁵⁸ Shih raportin për Evropë i Grupit të Krizave, numër 155, *Kolapsi në Kosovë*, 22 prill, 2004.

¹⁵⁹ Në mënyrë më eksplicite, artikulli 5 i Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (SCP), shih fusontën 6 më lartë.

¹⁶⁰ Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, aneksi 5, 26 mars, 2007.

¹⁶¹ Ibid, aneksi 5, artikulli 1.

¹⁶² Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë serbë, Beograd/Graçanicë/Mitrovicë, 2008-2010.

¹⁶³ Intervistë e Grupit të Krizave, prift ortodoks serb, 14 qershor, 2010.

¹⁶⁴ Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, aneksi 5, artikulli 3.1.1.

¹⁶⁵ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë serbë/prift ortodoks serb, qershor-korrik, 2010.

¹⁶⁶ Në praktikë, deputetët serbë mund të bllokojnë amandamentimin e kushtetutës së Kosovës, për cka nevojitet dy të tretat e gjithë deputetëve dhe dy të tretat e njëzet deputetëve “joshumicë”; serbët i kanë garantuara 10 ulëse, në këtë grupin e fundit. Kushtetuta, artikujt 64.2.1, 65.2, 144.2. Për këtë arsye, fuqizimi dhe interpretimi kreativ është më i rrezikshëm se sa amandamentimi formal.

¹⁶⁷ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të kishës serbe dhe diplomatë, Beograd dhe Kosovë, qershor-korrik, 2010.

¹⁶⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 15 qershor, 2010; zyrtar ndërkombëtar, Beograd, 18 korrik, 2010; prift ortodoks serb, 19 korrik, 2010.

¹⁶⁹ “Vendosja e Komunitetit Monastik Ortodoks Serb (SOMC) në Kosovë, si pjesë përbërëse e zgjidhjes gjithëpërfshirëse të “statusit të ardhshëm””, ELIAMEP, jo-letër, 1 nëntor, 2005.

sovrانيتet mbi pjesën tjetër të Kosovës, përveç zonave ku ndodhen disa nga manastiret tona më të rëndësishme.”¹⁷⁰ Karakteri i ekstraterritorialitetit do të varej nga rasti në rast. Manastiret në mes të vendbanimeve urbane, si Bogorodice Ljeviska në Prizren do të duhej të kishin një shenjë të posaçme, ndoshta një lloj tjetër të gurit në kalldrëmin rrethues, ndërsa ekstraterritorialiteti i manastireve më të izoluar, si Deviçi dhe Engjujt e Shenjtë, do të shtriheshin deri te muret e jashtme. Autoritetet e larta të kishës kanë argumentuar se ekstraterritorialiteti në “thelb dhe formë” do të ishte i domosdoshëm.¹⁷¹

Kjo çështje është kontraverze dhe një marrëveshje eventuale do të varej pjesërisht nga ajo se sa territor do të ishte ekstraterritorial dhe se a do të ishte Kisha apo shteti serb sovran. Ndryshimi i statusit të disa kishave do të ishte me pak i bezdisshëm sesa diskutimi i territoreve më të gjera rreth kishave që vendoset nga Aneksi 5 dhe përfshin patundshmëri në pronësi të kishës. Gjithashtu, ekstraterritorialiteti klerikal mund të ofendojë më pak ndjenjat Kosovare se sa prania formale e shtetit Serb. Zyrtarët lokalë të kishës në Kosovë anojnë më pak ndaj një ekstraterritorialiteti formal sepse shumica e monumenteve të rëndësishme fetare serbe gjenden në zona shqiptare,¹⁷² të cilët do të shihnin statusin e ri si një fyerje që do të ngjallte armiqësi.¹⁷³

Tema nuk është po aq e diskutuar në Prishtinë, ku zyrtarët përsërisin se ata do të ndjekin planin Ahtisaari në tërësi, duke përfshirë Aneksin 5. Për aq kohë sa pavarësia e Kosovës është nën mbikëqyrje ndërkombëtare, mbrojtja e veçantë e Kishës Ortodokse serbe është e sigurt. Disa zyrtarë kosovarë nuk pajtohen me këto të drejta speciale dhe do të dëshironin që ato të reduktohen deri në nivelin që i ofrohen komunitetit shumë më të madh Islamik.¹⁷⁴ Sidoqoftë aktorët ndërkombëtarë të përfshirë në këtë proces besojnë se mundësitë që kjo do të ndodhë janë të vogla pasi që rruga e Kosovës për në BE do të bllokohej nëse Kosova do ta keqtrajtohej Kishën.¹⁷⁵ Megjithatë, pozita dhe mënyra e jetës e Kishës do të mund të bëhëj

gradualisht më pak e mbrojtur në përballje me shkelje dhe veprime tjera flagrante. Priftërinjtë dhe murgjit drujnë se fqinjët armiqësorë laikë mund të industrializojnë ose të shfityrojnë tokën pranë manastireve të tyre, si kanë bërë liderët komunistë në kohën e Jugosllavisë. Më shqetësuese janë përpjekjet nga ana e nacionalistëve shqiptarë për të përvetësuar Kishën Ortodokse Serbe si një trashëgimi kosovare që serbët e kanë uzurpuar,¹⁷⁶ një qëndrim që e shton mosbesimin dhe tensionin midis Prishtinës dhe Kishës.

Zyrtarët Kosovarë i hedhin poshtë bisedimet mbi ekstraterritorialitet, duke theksuar që kjo mund të çojë në një “shtet brenda një shteti”.¹⁷⁷ Kjo brengë është veçanërisht e theksuar në monumente si manastiri i Graçanicës, që janë të rethuar nga vendbanime me shumicë serbe: Kosovarët brengosen se një entitet kishtar do të provonte të zgjeronte ekstraterritorialitetin e tij në këto zona dhe kështu do të ndërpriste sovranitetin e Prishtinës.¹⁷⁸ Zyrtarë të lartë të Kishës mohojnë interesa të tilla për zgjerim.¹⁷⁹ Kosovarët janë më rehat, por jo entuziastë, me një ekstraterritorialitet që do të ishte kryesisht simbolik dhe që do të mbulonte vetëm zona të vogla.¹⁸⁰ Ata do të ishin të gatshëm të konsideronin garancione shitesë, duke përfshirë një prani afatgjatë të forcave ndërkombëtare të sigurisë, privilegje praktike dhe qasje të lirë për zyrtarë serbë që duan t’i vizitojnë.¹⁸¹ Për sa i përket çështjeve të Kishës kundërshtarët janë më fleksibil; një nga liderët e lartë të Kishës ka thënë se kisha do të mund të merrte “çfarëdo që donte” brenda kufijve të arsyes.¹⁸²

Ekstraterritorialiteti për disa monumente fetare brenda Kosovës do të ndihmonte në bindjen e popullit serb për një marrëveshje, por nuk do të pëlqëhej nga shqiptarët e Kosovës. Aprovimi i Kishës do të ishte kyç, meqenëse është institucioni më i besuar në Serbi. Termi ekstraterritorialitet është shumë kontraverz; sidoqoftë secili shtet ka zona ekstraterritoriale, të paktën në formën e ambasadave dhe konsullatave. Në praktikë, zonat e pakta të zgjedhura nuk do të ishin mjaft të fuqishme ose të mëdha për të

¹⁷⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 15 qershor, 2010.

¹⁷¹ Intervistë e Grupit të Krizave, prift ortodoks serb, 19 korrik, 2010.

¹⁷² Vlen sidomos për Deqanin, Deviçin, Ljevishka Bogorodicën dhe Patriarkanën e Pejës. Vetëm Graçanica, banjksa dhe kishat e Hoqës së Madhe janë në pjesë të banuara me shumicë serbe.

¹⁷³ Intervistë e Grupit të Krizave, prift ortodoks serb, 14 qershor, 2010. Beogradi nuk i jep rëndësi të madhe kësaj brengje dhe thotë se ekstraterritorialiteti do të ishte pjesë e një zgjidhjeje më të madhe nga e cila Prishtina do të fitonte legjitimitet të plotë ndërkombëtar, duke ulu kështu tensioned. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 9 korrik, 2010.

¹⁷⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i Kosovës, Prishtinë, 14 korrik, 2010.

¹⁷⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Beograd, 18 korrik, 2010.

¹⁷⁶ Ibid.

¹⁷⁷ Ibid.

¹⁷⁸ Aneksi 5 i referohet provizioneve të vecanta të cilat zonave si ajo e Hoqës së Madhe – ku zgjidhja sekulare dhe pronat e kishës shpesh ndëshen mes vete e ku fshati i vogël ka një numër mjaft të madh të kishave mesjetare – u jep të drejtën e diskutimit të një sërë çështjesh me Kishën.

¹⁷⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, prift ortodoks serb, 18 korrik, 2010.

¹⁸⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Beograd, 18 korrik, 2010.

¹⁸¹ Intervista të Grupit të Krizave, ministër në qeveri dhe zyrtarë, Prishtinë, korrik, 2010.

¹⁸² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i AAK-së, Prishtinë, 9 qershor, 2010.

cënuar në mënyrë të domethënshme autoritetin e Prishtinës ose mënyrën e jetesës së shqiptarëve.

B. ÇËSHTJE TEKNIKE

Mospranimi i Serbisë për të njohur Kosovën ka thëlluar një numër të problemeve teknike. Prishtina do të donte të përqëndrohej në këto probleme për të krijuar mirëbesim dhe marrëdhënie të mira fqinjësore. Ka një bindje në Kosovë, e ndarë nga BE dhe SHBA, që bashkëpunimi me Serbinë mund të arrijë nivele që do të kënaqnin nevojat dhe interesat bazë të qytetarëve pa njohje formale nga Serbia.

Aktualisht Serbia i bllokoi qytetarët e Kosovës gati në çdo kthesë. Ata nuk mund të udhëtojnë, studiojnë, punojnë ose të kalojnë përmes Serbisë nëse nuk kanë dokumente të lëshuara nga Beogradi. As dokumentet e Kosovës e as ato të UNMIK-ut nuk njihen. Serbia refuzon të flasë me qeverinë e Kosovës ose kompani private mbi çështje që lidhen me ujin, energjinë, transportin, sundimin e ligjit, personat e zhvendosur apo të humbur, tregti apo çfarëdo çështje tjetër të përbashkët. Në të njëjtën kohë ajo mundohet të mbajë kontrollin mbi furnizuesit e këtyre shërbimeve dhe mallrave në veri të Kosovës dhe bllokoi pjesëmarrjen e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale. Të gjitha këto i ndëshkojnë shqiptarët e Kosovës duke bërë shumë pak në të mirë të serbëve.

Përpjekjet ndërkombëtare të kryesuara nga BE për të zbutur fushatën e Serbisë për të izoluar Kosovën kryesisht kanë dështuar. EULEX-i është munduar dy herë që të përmirësojë bashkëpunimin (në polici dhe gjyqësi); të dyja tentativat kanë qënë nënshtruese ndaj Beogradit dhe kanë arritur shumë pak përveç se e kanë ofenduar Prishtinën, e cila është mbajtur në distancë nga bisedimet. EULEX-i gjithashtu ka shkelur aq "lehtë" në Veri sa që nuk vihet re; një ambasador i një shteti anëtar të BE-së ka thënë se për Brukselin qëllimi kryesor i EULEX-it është të mbajë unitetin e BE-së dhe kjo ka bllokuar çfarëdo qëllimi të politikave në Kosovë.¹⁸³ Liderët e BE-së janë tërhequr nga një mbledhje rajonale më 20 mars 2010 kur presidenti Boris Tadiç ka thënë se nuk do të merrte pjesë nëse zyrtarë kosovarë do të ishin të pranishëm.¹⁸⁴ Vendimi i GJND-së vështirë se do të kishte ndonjë efekt mbi mosnjohësit në BE ose në aftësinë e Brukselit për të diskutuar në mënyrë produktive me Beogradin dhe Prishtinën përveç nëse të dy palët pranojnë të diskutojnë me njëra-tjetrën si të barabartë.

¹⁸³ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 24 maj, 2010.

¹⁸⁴ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të BE-së, Paris, Prishtinë dhe Sarajevë, mars-maj, 2010. Një takim i mëvonshëm i i ministrave të jashtëm i sponsoruar nga BE-ja i mbajtur në Sarajevë, i bashkoi zyrtarët e Serbisë dhe të Kosovës, por pasi që agjenda u thjeshëzua në linjë me brengat serbe.

Beogradi nuk tregon ndonjë shenjë se do ta bëjë këtë për bisedime mbi "çështje teknike" duke thënë se këto bisedime do të ishin një "mbulesë" për njohje.¹⁸⁵ Gjatë një debati parlamentar pas GJND-së në korrik të këtij viti, ministri i jashtëm Vuk Jeremiç ka konstatuar se të lejuarit e Kosovës për të marrë pjesë në forume rajonale ose ndërkombëtare të tjera do të ishte e barabartë me njohje të nënkuptuar dhe do t'i dërgonte një mesazh botës se Serbia është më e qetë me pavarësinë e Kosovës.¹⁸⁶ Kështu Serbia refuzon të hyjë në bisedime të kufizuara në çështje teknike dhe thotë se fillimi i këtyre të fundit do të jetë rezultati i marrëveshjeve të përbashkëta mbi çështjet më të gjëra.¹⁸⁷

1. Doganat dhe tregtia

Anëtarësimi i Serbisë në Marrëveshjen për Tregti të Lirë të Evropës Qëndrore e Lindore (CEFTA), që filloi në shtator 2007, ishte paraprirë nga negociata të vështira mbi statusin e Kosovës brenda kësaj organizate. Qeveria e Koshtunicës ka pranuar një kompromis në të cilën ka pranuar se Kosova është një zonë e veçantë e tregtisë dhe është pajtuar me hyrjen e Kosovës në CEFTA si "UNMIK-Kosovo". Kjo ka qënë e vlefshme deri në shpalljen e pavarësisë të Kosovës. Që nga kjo kohë Serbia ka refuzuar të merret me Kosovën në çfarëdo mënyre tjetër përpos UNMIK-Kosovo, ndërsa Kosova insistonte në praninë e saj si sovranë pa OKB-në shoqëruese. Përfundimisht Beogradi bllokoi pjesëmarrjen e plotë të Kosovës dhe edhe pse kishte mundur të pranonte përfaqësimin nën ombrellën e UNMIK-ut, Kosova ka vendosur të durojë çmimin financiar dhe politik të pamundësisë të qarkullimit të mallrave të saj qoftë edhe në mënyrë tranzite në Serbi.¹⁸⁸

¹⁸⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë serbë, Beograd, mars-qershor, 2010.

¹⁸⁶ Mbledhje e jashtëzakonshme për Kosovën e parlamentit serb, 26 korrik, 2010.

¹⁸⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 15 qershor, 2010.

¹⁸⁸ E krijuar më 1992, CEFTA (Marrëveshja për Tregëti të Lirë të Evropës Qëndrore Lindore) synon të ndihmojë shtetet që nuka janë anëtare të BE-së të integrohen në institucionet perëndimore evropiane. Është zgjeruar edhe në Ballkanin perëndimor, dhe pritet të hyjë në fuqi në fund të vitit 2010. Të gjitha shtetet e Ballkanit perëndimor përfshirë Serbinë dhe Kosovën (si UMIK-Kosovë) janë anëtarësuar më 2007, duke u zotuar kështu për ktijimin e ekoomisë së tregut të lirë dhe lëvizjen e lirë të mallrave për anëtarët të cilët janë marrë vesh për eliminimin e tarifave e kuotave. Prej shpalljes së pavarësisë, Kosova ka refuzuar të identifikohet si "UNMIK-Kosovë" dhe dëshiron të shfrytëzojë vullat dhe dokumentet në të cilat figuron emri i saj i saktë. Serbia nuk pranon dhe nllokon të gjitha vullat të cilat nuk kanë mbishkrimin UNMIK-Kosovë. Zyrtarët kosovarë thonë se kjo është në kundërshtim me CEFTA-n dhe

Beogradi thotë se do të zhblllojë Kosovën nëse ka qoftë edhe një “prani simbolike të UNMIK-ut”,¹⁸⁹ por mosgatishmëria për të bërë kompromis më të përgjithshëm e bën jo shumë të besueshme pozitën e tij. Kjo bëhet më e vërtetë pasi që ajo dy here i ka refuzuar opinionet ligjore të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Lamberto Zannieri, ku thuhet se vulat “Doganat e Kosovës” janë në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Zannier po konsideron përdorimin e kryesimit të organizatës nga UNMIK-Kosovo për të kërkuar një gjykim mbi shkelle të CEFTA-s nga Serbia në raport me Kosovën.¹⁹⁰

Këto shkelle nuk e dëmtojnë vetëm Kosovën por gjithashtu edhe shtete të treta, importet kosovare të cilave janë më të shtrenjta për shkak të tranziteve më të gjata. Kosova është një treg i fortë i eksportit për Serbinë prandaj marrëdhëniet e mira ekonomike janë të rëndësishme. Kosova mund të vendosë tarifa më të larta ose të marrë masa të tjera ndaj mallrave të Serbisë që mund të çojnë në sfidimin e përparësisë serbe në treg nga konkurrentët si Maqedonia dhe Sllovenia.

2. Telekomunikimi

Operatorët telefonik serbë kanë qenë në Kosovë para konfliktit të vitit 1999 dhe kanë mbetur kryesisht të paprekur deri vonë. Operatori shtetëror, Mobilna Telefonija Srbije (MTS), ka zhvilluar dhe freskuar rrjetin e tij në Kosovë dhe deri më 2010 sinjali i tij ka mbuluar shumicën e territorit. “Mobitel”, prona e një magnati serb të Kosovës, Bogoljub Kariç, para se të konfiskohej nga Beogradi dhe ti shitej operatorit norvegjez Telenor, ka bashkëpunuar mirë me afaristë shqiptarë por kurrë nuk është regjistruar zyrtarisht në Kosovë.

Sidoqoftë Prishtina nuk do të tolerojë më operatorët e paregjistruar serbë, pjesërisht për shkak të humbjeve në të ardhura nga taksat, dhe tani po bën çmos për të çmontuar 22 shpërndarësit e rrjetit në jug të Ibrit. Në prill të vitit 2010, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) ka ndërprerë pa paralajmërim punën e disa antenave të MTS-së duke e zbritur dramatikisht kapacitetin e rrjetit, por nuk është në gjendje të fikë dhjetë antenat e tjera në Veri. Nëse Beogradi nuk arrin një marrëveshje me Prishtinën, operatorët mobil do të vazhdojnë të vihen në

mospëmbushje e zotimit për tregëti të lirë nga ana e Serbisë. Zyrtarët serbë thonë se mosmarrëveshja tregon se Kosova vendos politikën para ekonomisë. Mungesa e bashkëpunimit pengon përgaditjet thelbësore dhe lë të kuptohet se CEFTA mund të mos jetë tërësisht funksionale edhe pas dhjetorit, 2010.

¹⁸⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 9 mars, 2010.

¹⁹⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i UNMIK-ut, Prishtinë, 10 qershor, 2010.

shenjë edhe pse ART-ja është zotuar se do të jetë e kujdesshme dhe se do t'i shmanget provokimit të serbëve lokalë.¹⁹¹

Beogradi duhet t'i lejojë të gjithë operatorët të regjistruohen në Kosovë dhe Prishtina duhet të lejojë që kjo të ndodhë në baza të favorshme në mënyrë që përdorimi i telefonave mobilë i popullatës lokale të mos pengohet.¹⁹² Idealisht, një zonë e vetme e rrjetit duhet të vendoset në gjithë rajonin duke menjanuar çmimet e roamingut. Serbia gjithashtu duhet të njohë operatorin kosovar Vala, sektorin mobil të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK), e cila është regjistruar nga UNMIK-u.

Edhe pse entitete me lloje të ndryshme të statusit të veçantë si Taivani, Martinique dhe Honk Kong-u kanë kodet e tyre telefonike, Serbia refuzon të shqyrtojë mundësinë e dhënies së një kodi të tillë Kosovës duke insistuar që i ka mbajtur të gjitha linjat tokësore dhe të internetit në territor.¹⁹³

3. Energjia elektrike

Kosova e ka zgjidhur problemin e mospagesës së rrymës nga serbët e Kosovës në jug të lumit Ibër në vitin 2009 në mënyrë të suksesshme duke e ndërprerë furnizimin dhe duke kërkuar nënshkrimin e një kontrate me një çmim fiks mujor për shtëpi prej 27 eurosh, para se të rikthejë energjinë elektrike.

Të mbështetur nga Beogradi, serbët e Kosovës në fillim kanë protestuar por në fund janë pajtuar me këtë rregull. Në dimër të vitit 2009, Prishtina ka menduar se kjo taktikë do të funksiononte gjithashtu në Veri, borxhi i të cilit mendohet se arrin shumë prej 50 milion eurove, sipas përlloraritjeve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).¹⁹⁴

¹⁹¹ ART është i ndarë mes mbajtjes së stabilitetit dhe presioneve nga dy operatorët legal të telefonisë mobile, VALA dhe IPKO, të cilat mund ta akuzojnë ART-në për humbjet ekonomike që ua shkaktojnë operatorët illegal. Komuniteti ndërkombëtar ka mbështetur veprimet e ART-së por ka kritikuar implementimin e tyre dhe potencialin për reagim të dhunshëm nga ana e serbëve. ART-ja thotë se do të vazhdojë me operacionet e saj pas pushimeve të verës por vetëm me pëlqimin e policisë. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i ART-së, Prishtinë, 1 gusht, 2010.

¹⁹² Ekziston një precedent në rajon: MTS-ja dhe Telenori në Bosnje dhe Mal të Zi lejojnë thirrjet nga Serbia dhe në Serbi pa “roaming”.

¹⁹³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar serb, Beograd, 15 qershor, 2010.

¹⁹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i KEK-ut, Prishtinë, maj 2009. Sipas tij, borxhi i përgjithshëm i konsumatorëve serbë është 120 milion euro.

Sidoqoftë, pas disa ditësh në mungesë të energjisë elektrike, Veriu ka qenë i aftë të furnizojë veten nëpërmjet burimeve alternative.¹⁹⁵ Praktikisht, KEK-u ka humbur përgjegjësinë për të furnizuar këtë zonë kurse pronat e saj, përfshirë këtu stacionin furnizues të Valaçit, janë uzurpuar nga Elektrokosmeti i Serbisë. Nga janari 2010, kjo ndërmarrje serbe ka filluar të faturtojë konsumatorët e Veriut.¹⁹⁶

Thashetheme për intervenim ushtarak për të rimarrë Valaçin kanë qarkulluar përgjatë 2010-ës dhe situata akoma mbetet e pazgjidhur. KEK-u ka rifilluar përcimin e rrymës për në veri,¹⁹⁷ ndërsa Serbia thotë se nuk po pengon energjinë elektrike të KEK-ut dhe se po sillet me kujdes për të mos provokuar KFOR-in ose forca të tjera të sigurisë. Prishtina po ndërton një stacion modern të rrymës elektrike në perëndim të vendit në mënyrë që këto zona të mos mbeten pa energji në rast të ndërprerjes nga Valaçi. Sidoqoftë të dy gjysmat e Mitrovicës janë të varura nga njëra-tjetra dhe Valaçi është i vetmi stacion në veri nëpërmjet të cilit bëhet shpërndarja e rrymës në tërë rajonin pa marrë parasysh burimin.

Qeveria ka paraqitur një projekt për të privatizuar degën për shpërndarje të energjisë të KEK-ut dhe ofertat formale priten në vitin e ardhshëm. Privatizimi mund të ulë tensionet meqenëse procesi do të jetë i hapur për ofertues ndërkombëtarë të cilët do të duhet të kalojnë nëpër procesin e rregullt kosovar të ofertimit dhe licensimit. Pronarët e rinj do të jenë të lirë të vendosin se kush do të furnizojë Veriun dhe do të jenë kryesisht të koncentruar në mbledhjen e pagesave nga konsumatorët.

Banorët në veri kanë qenë të prirur të mos paguajnë askënd për energji elektrike por ata nuk do të kenë më një justifikim të përshtatshëm politik për të mos paguar kur një operator që nuk i përket shtetit të Kosovës bëhet pronar.

4. Transporti

Pavarësisht numrit të madh të marrëveshjeve me UNMIK-un në periudhën 2001-2006, qeveria serbe refuzon të njohë tabelat e Kosovës, dokumentet e automjetit, policat

e sigurimit si dhe dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut. Kjo e cënon seriozisht lirinë e lëvizjes të qytetarëve dhe mallrave të Kosovës. As UNMIK-u e as BE-ja nuk kanë qenë në gjendje t'i bindin serbët e Kosovës të vozisin me tabela të Kosovës e as Beogradin që të lejojë automjete të regjistruara nga UNMIK-u të udhëtojnë nëpër Serbi. Në vend të kësaj, UNMIK-u e zgjat përdorimin e tabelave të vjetra serbe çdo gjashtë muaj, një hap ky që nuk do të pranohet pafundësisht nga qeveria e Kosovës dhe që në njëfarë mase e minon rendin publik. Prishtina e ka shtyer futjen e tabelave të reja të Kosovës dhe është e gatshme të mundësojë një dizajn të ngjashëm me ato të UNMIK-ut ku përdoret KS (Kosovo) në vend të RKS (Republika e Kosovës)¹⁹⁸. Por, është e domosdoshme për Kosovën që automjetet e saja të mund të kalojnë nëpër Serbi për të arritur në BE.¹⁹⁹ Problemi prek edhe ndërkombëtarët; ata që futen në Kosovë nëpërmjet një kufiri jo-serb (përshebull nga ajri) nuk lejohen të futen drejt në Serbi; ata duhet të dalin nga Kosova, pastaj të kalojnë nëpër një kufi jo-kosovar.²⁰⁰

Pas deklarimit të pavarsisë së Kosovës, Hekurudhat e Serbisë kanë marrë pronësinë e linjave të trenit në veriun e Kosovës duke i shtrirë shërbimet e tyre të trenave nga Serbia në Zveçan, 40km brenda territorit të Kosovës. Si kundërpërgjigje Prishtina i ka ndaluar trenat nga jugu, duke përfshirë një linjë të vendosur nga UNMIK-u që ka shkuar nga enklavat jugore në veri. As UNMIK-u e as KFOR-i nuk kanë reaguar. Për shkak të kësaj, përderisa serbët e Kosovës nga veriu mund të udhëtojnë për në Serbi, të afërmit e tyre entik në jug nuk mund të shkojnë më në Mitrovicë apo Serbi sikur që bënin para se kontrolli i linjave të ndryshonte. Kosova kërkon kontrollin e linjës por nuk mund të marrë kontrollin vetë kurse gatisshmëria e ndërkombëtarëve për ta ndihmuar është e vogël.

Prishtina pret me padurim një zgjidhje të këtyre problemeve. Ajo është e gatshme të përdorë minimumin e dokumentacionit kufitar dhe të lejojë kalimin e personave më letërnjoftim në vend të pasaportës.²⁰¹ Më 2 korrik 2010, me shpresën se eventualisht do të fusë regjistrimin e saj të automjeteve, Prishtina ka hapur një zyre në Mitrovicën e Veriut në mënyrë që dokumentet civile kosovare të jenë më pranë serbëve lokalë; megjithatë kjo ka shkaktuar demonstrata që kanë çuar në një vdekje dhe disa lëndi-

¹⁹⁵ Komuna e Zubin Potokut ka siguruar burimin alternative të rrymës kryesisht përmes liqenit të Gazivodës, kurse leposaviqi, Zveçani dhe Mitrovica e kanë siguruar ate nga Novi Pazari në serbi përmes elektranës së Valaçit.

¹⁹⁶ Pagesa e këtyre faturave ka qenë kryesisht në bazë vullnetare, për shkak të mungesës së policisë dhe gjykatave në strukturat paralele. Shume nga punëtorët e Elektrokosmetit të cilët kanë dashur t'ua ndërprejnë rrymës atyre që nuk kanë paguar, janë sulmuar nga këta të fundit.

¹⁹⁷ Zyrtarë serbë atje thonë se energjia elektrike thjeshtë ridrejtohet përmes Valaçit në drejtim të zonave shqiptare. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i serbëve të Kosovës, Zubin Potok, 30 qershor, 2010.

¹⁹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i qeverisë, Prishtinë, korrik, 2010.

¹⁹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, presidenti Fatmir Sejdiu, Prishtinë, 14 korrik, 2010.

²⁰⁰ Në praktikë, kjo nuk ka ndikim në poseduesit e dokumenteve të zonës Shengen, pasi që Serbia i pranon ata me vetëm me letërnjoftim të cilët nuk tregojnë vulën e Kosovës.

²⁰¹ Intervistë e Grupit të Krizave, ministra të PDK-së dhe LDK-së, Prishtinë, korrik, 2010.

me.²⁰² Nëse nuk arrihet një marrëveshje se shpejti, është e mundur që qarkullimi i automjeteve me tabela të Serbisë të kufizohet dhe të futen tarifa të larta të sigurimit dhe kalimit të kufirit.²⁰³ Afaristë nga zona shqiptare dhe serbe të Kosovës shpesh janë të regjistruar në autoritetet kosovare dhe serbe dhe i ndërrojnë tabelat kur vozisin nga veriu për në jug.

Që nga Korriku i vitit 2008 Serbia ka lejuar aeroplanët të fluturojnë mbi Mal të Zi për në Kosovë dhe nga Kosova – me marrëveshje Serbia është kompetente për kontrollin e trafikut ajror të Malit të Zi – por ajo lejon vetëm fluturime ruse dhe ushtarake të fluturojnë për në Kosovë nëpër territorin e saj.²⁰⁴ Fluturimet për në Prishtinë dhe nga Prishtina, shumë prej tyre në agjenci të BE-së, duhet të udhëtojnë nëpër vija që e mënjanojnë Serbinë duke harxhuar karburant, keqësuar ndotjen dhe duke rritur çmimet. Një masë relativisht e thjeshtë për të ndërtuar mirëbesim do të ishte të lejohen fluturimet në hapësirën ajrore të saj; në të njejtën kohë KFOR-i duhet të lejojë fluturime në lartësi të mëdha mbi territorin e Kosovës të cilat tani për tani janë të ndaluara.²⁰⁵

V. ALTERNATIVA PËR NJË MARRËVESHJE GJITHËPËRFSHIRËSE

Bisedimet gjithëpërshirëse – nëse mund të fillojnë fare – mund të jenë të komplikuar dhe do të mund të dështojnë. Për një sukses të plotë Kosova dhe Serbia duhet të pajtohen mbi njohjen, kufijtë, situatën në Veri dhe statusin e hapësirave fetare në Kosovë. Nga këto çështje, Veriu, me të trija opsionet për të – planin e Ahtisarit, autonominë e zgjeruar ose shkëmbimin e territoreve – është më i komplikuari, dhe mbetet problemi për të cilin liderët politikë janë larg pajtimit. Në vend se t'i lënë bisedimet të dështojnë, palët mund të konsiderojnë qasje të tjera që thelbësisht do të shtynin për momentin zgjidhjen e statusit për Veriun duke ecur kështu përpara në tema të tjera të cilat mund të jenë kanë gjasa më të mira për tu zgjidhur. Alternativisht, komuniteti ndërkombëtar mund të provojë të detyrojë një zgjidhje për Veriun edhe pse kjo do të kërkonte nga ata shumë më shumë burime – kapital politik dhe trupa – sesa kanë qënë të gatshëm të angazhojnë deri tani.

A. NGRIJE VERIUN, SHKRIJI TË TJERAT

Një zgjidhje e përkohshme e cila do të shtyente mosmarrëveshjen rreth Veriut por do të paraqiste progres thelbësor, do të mund të përmbante të gjitha apo disanga elementet e mëposhtme:

- ❑ **Monumentet fetare.** Në një marrëveshje bilaterale të garantuar nga BE-ja dhe SHBA-ja që do të hynte në fuqi në një datë të pranuar nga të dyja palët, Kosova do ti jepte Kishës Ortodokse Serbe sovranitet eks-territorial mbi manastiret më të rëndësishme ndërkohë që do të mbante kushtet e planit të Ahtisarit për zonat e mbrojtura dhe monumentet e tjera fetare dhe do të thirrte një palë e tretë për të siguruar mbrojtje afatgjate për manastiret më të pambrojtura.
- ❑ **Kufijtë e brendshëm të Serbisë.** Serbia to të miratonte legjislacionin i cili do të rishkruante kufinj të asaj të cilës ata i referohen si “Provinca Autonome e Kosovës”, duke e lënë jashtë kufijve Veriun, dhe do të amandamentonte kushtetutën e saj për të lejuar entitetin e mbetur të bëhet i pavarur.
- ❑ **Njohje pa marrëveshje të plotë mbi kufijtë.** Kosova dhe Serbia do ta njihnin njëra-tjetrën dhe do të shkëmbenin përfaqësues diplomatikë pa pranuar plotësisht pretendimet territoriale të njëri-tjetrit apo pikëpamjet legale. Problemi territorial mbi Veriun do të mbetej, ndërsa të dy shtetet do ti mbanin pretendimet e tyre për këtë pjesë. Ka dy precedentë të suksesshëm evropianë për këtë: Grundvertrag (Traktati Bazik) i 21 dhjetorit, 1972, i cili i ka vendosur marrëdhëniet

²⁰² Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë qeveritarë, Prishtinë, korrik, 2010; Bojana Barlovac, “Një i vrarë, 11 të plagosur në shpërthimin në Mitrovicën e veriut”, *Balkan Insight*, 2 korrik, 2010 (online).

²⁰³ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë të qeverisë, Prishtinë, korrik, 2010.

²⁰⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i OKB-së, Prishtinë, 10 qershor, 2010.

²⁰⁵ Nën mbikqyrjen e NATO-s, Kosova kontrollon hapësirën ajrore të saj deri në FL190 (rreth 9,000 kilometra mbi nivelin e detit); hapësira mbi këtë lartësi është e mbyllur për trafik dhe kontrollohet nga KFOR-i sic parashihet me marrëveshjen tekniko-ushtarake të Kumanovës të 9 qershorit, 1999, e nënshkruar me Serbinë.

ndërmjet Gjermanisë Lindore dhe asaj Perendimore, edhe pse kjo e fundit ka mbajtur një angazhim kushtetues për ribashkim dhe pozita legale e saj ka qënë se kjo nuk është një marrëdhënie midis shteteve të huaja; dhe marrëdhënia Anglo-Irlandeze gjatë së cilës pretendimet kushtetuese të Republikës të Irlandës ndaj Veriut të Irlandës nuk i kanë parandaluar bisedimet diplomatike me Britaninë e Madhe.²⁰⁶

- **Një rezolutë e re e Këshillit të Sigurimit.** Rezoluta 1244 e 10 qershorit 1999, akoma mbetet në fuqi, edhe pse masat e saj tanimë injorohen gjërësisht.²⁰⁷ Rusia dhe Kina nuk do ta konsiderojnë revokimin e rezolutës pa miratimin e Serbisë dhe kjo mosmarrëveshje e bllokon Këshillin e Sigurimit në një pozitë të irrelevantës progresive në Kosovë. Me njohje të ndërsjellë, Këshilli do të mund të zëvendësonte 1244 me një rezolutë të re duke vërtetuar marrëveshjen Serbi-Kosovë dhe duke bërë thirrje për vendosjen e një autoriteti administrativ të përkohshëm të OKB-së ose më mirë të BE-së, në Veriun e polemizuar për një periudhë me afat të hapur, në pritje të një marrëveshje të mëvonshme.
- **Më shumë bashkëpunim në Luginën e Preshevës.** Serbia do të lejonte Prishtinën të financojë komunat në Preshevë në kategoritë për të cilat palët janë pajtuar më herët siç janë edukimi dhe kultura. Përparimi në fushat e lartëpërmendura do të linte Kosovën dhe Serbinë në një gjendje të paqartë për statusin e Veriut dhe kufijve të tyre ndërsa do t'i lejonte të shkonin përpapra në fusha të tjera. Çështja e veriut do të vazhdonte të komplikonte dhe me siguri të shtynte kandidimin për në BE për të dyja shtetet edhe për një kohë. Megjithatë në këtë skenar Kosova do të fitonte njohjen (por pa caktim të kufijve) dhe Serbia do të kishte një rezolutë të re që e justifikonte ligjërisht statusin e përkohshëm të Veriut, duke e vënë kështu në dyshim sovranitetin e Kosovës në këtë rajon. Një përpjekje për të gjetur zgjidhje për statusin e Veriut do të ishte e mundur kur mirëbesimi i ndërsjellë do të

ishite rritur, anëtarësia në BE do të ishte me e afërt për të dyja shtetet dhe kur BE-ja do të kishte më shumë aftësi manipulimi për të lehtësuar një zgjidhje më të qëndrueshme.

Nëse ky skenar do të paraqitej kosovarëve edhe serbëve, asnjëri nuk do ta shihte si tërheqës për shkak se do të përfshinte kompromise të vështira si dhe mbajtjen e disa pengesave që sjellë mbajtja e “status quo”-së. Por ata gjithashtu do të ballafaqoheshin me pyetjen nëse tani është koha t’i zgjidhin të gjitha problemet e tyre, dhe nëse jo, a mund të konsiderohet ndonjë lëvizje drejt një qëllimi jo tërësisht të sigurtë më mirë sesa stagnimi i plotë.

B. DËRGONI TRUPAT

Ka shumë pak gatishmëri për opsionin tjetër i cili është diskutuar në dekadën e kaluar, pra një qasje e vrazhdë ndaj Veriut. Shqiptarët e Kosovës kanë kritikuar rëndë paqeruajtësit dhe policinë ndërkombëtare që nuk kanë bërë më shumë për ta bërë praninë e tyre atje më të dukshme dhe efektive. Kundërshtimi serb në veri shihet si rezultat i mungesës së gatishmërisë nga çdokush, nga UNMIK-u deri te KFOR-i dhe EULEX-i për të imponuar sundimin e ligjit. Ballafaqimi rreth energjisë elektrike në Veri në dimrin 2009-2010, ka prodhuar thirrje të reja për intervenim ushtarak.²⁰⁸

Lidershipi kosovar thotë se do të dëshironte që komuniteti ndërkombëtar ta përdorë forcën nëse është e domosdoshme për të marrë masa për ekstremistët e sponsorizuar nga Beogradi që rezistojnë çfarëdo përpjekje për integrim. Ata sugjerojnë që një forcë e tillë do të ishte e fokusuar dhe e shkurtër, duke çuar në arrestimin e një grupi të politikanëve radikalë të lidhur me aktivitete kriminale. Megjithatë, duke u bazuar në intervista dhe vrojtimit të zgjeruar në Veri, Grupi i Krizave beson se rezistenca ndaj Prishtinës në Veri është më e thellë. Çfarëdo qasje për të intergruar veriun me forcë do të krijonte një reagim të ashpër nga populli; si pasojë, një prani e rëndë ushtarake do të ishte e nevojshme për të mbajtur “status-quo”-në.

Ka një konsensus të përgjithshëm që përdorimi i forcës ka pak gjasa të ndodhë.²⁰⁹ KFOR-i, siç është parë edhe gjatë epizodave të dhunshme në veri, si sulmi ndaj gjyqit të Mitrovicës më 2008, nguron ta rrezikojë personelin e tij dhe do të kundërshtonte një skenar të tillë. Intervenimi ushtarak është akoma më pak i mundshëm sot, pasi që

²⁰⁶ Republika e Irlandës hoqi dorë nga zonat e veriut vetëm në vitin 1999, si pjesë e marrëveshjes së Belfastit apo sic njihet edhe si marrëveshja “E premtja e mirë”.

²⁰⁷ Pavarësia e Kosovës nuk është konsistente me rezolutën dhe Serbia gjithnjë e më shumë i injoron provizionet e saj. Zgjedhjet serbe të majit, 2010 ishin në kundërshtim me dekretet e lëshuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral Joakim Ryker dhe Lamberto Zanierit; Serbia poashtu ka refuzuar ti rrespektojë vendimet e vazhdueshme të Zanierit rreth vulvae të doganave të Kosovës. Intervista të Grupit të Krizave, diplomat perëndimor, Prishtinë, 11 qershor, 2010; zyrtar i lartë i UNMIK-ut, Prishtinë, 10 qershor, 2010. Policia serbe, e larguar nga Kosova përmes rezolutës 1244, tashmë një kohë të gjatë ka qënë prezente në veri, në mënyrë të fshehtë, shih fusnotën 85 më lartë.

²⁰⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i KFOR-it francez, Prishtinë, nëntor, 2009.

²⁰⁹ Morton Abramovitz dhe James Hooper, “Rregullimi i Ballkanit”, *The National Interest*, 7 korrik, 2010. Ambasadori Abramovitz është anëtar i bordit të Grupit të Krizave.

NATO-ja e ka zvogëluar personelin e KFOR-it dhe planifikon zvogëlime të mëtejme.²¹⁰

Sidoqoftë serbët brengosen për një ndërhyrje eventuale në Veri. Zgjerimi i një baze të vogël të KFOR-it, Notting Hill në Leposaviç, për shembull, i brengosë zyrtarët lokalë.²¹¹ Ata që janë në terren i frikësohen një lloji të Operacionit Stuhi në të cilën trupat kroate pushtuan territorin e vogël serb të Krajines më 1995.²¹² Masmedia serbe gjithashtu është e vëmendshme në artikuj që drejtojnë gishtin kah një intervenim i mundshëm ushtarak.²¹³ Edhe pse situata momentalisht është e qetë, druajtje të tilla shumë lehtë mund të çojnë në incidente ose të shkaktojnë tensione.

VI. PËRFUNDIM

Miqtë e Kosovës dhe mbi të gjitha liderët e saj të durueshëm dhe të vendosur e kanë ndihmuar shtetin e vogël të arrijë pavarësi të pranueshme në mënyrë jo të dhunshme dhe, siç thotë edhe mendimi i GJND-së, pa thyer rendin e së drejtës ndërkombëtare. Liderët e Serbisë i kanë rezistuar kësaj pavarësie me të gjitha burimet diplomatike, ekonomike dhe ligjore që kanë mundur të mbledhin por gjithmonë e më shumë po e pranojnë – nëse jo akoma publikisht – që lufta e tyre është e humbur. Pavarësisht kësaj, integrimi i Kosovës në komunitetin ndërkombëtar nuk mund të përfundohet pa pëlqimin e Beogradit. Gjithashtu, anëtarësimi i Serbisë në institucionet e BE-së është bllokuar deri sa Kosova të trajtohet jo vetëm si një fqinj i mirë, por gjithashtu si një partner i barabartë.

Gjatë viteve të para pas luftës të vitit 1999 që përfundoi me mbikëqyrjen e territorit nga OKB-ja, Kosova dhe mbështetësit e saj e kanë ditur se marrja e njohjes nga ana e serbëve për një status të pavarësisë ishte e pamundur. Ata të paktën janë munduar t'i bashkojnë të dyja palët në një njohje të heshtur dhe të nivelit të ulët të njëri-tjetrit. Kjo, siç shpresohet, do të rritej me kohë në lidhje më substanciale dhe do të trasonte rrugën, për njohje zyrtare në të ardhmen kur pasionet nacionaliste do të ishin zvogëluar. "Dialog teknik" ishte mjeti për këtë taktikë, mjet të cilin Serbia vazhdimisht e ka refuzuar. Por miqtë e Kosovës do të bënin gabim ta detyronin atë të pranojë një dialog kaq të kufizuar, e që nuk është më i mjaftueshëm për një shtet i cili është shumë afër qëllimit të tij më të madh.

Serbia e ka luajtur lojën e saj keq. Duke pasur keqardhje të konsiderueshme ndërkombëtare me mundësi për të ju afruar Kosovës për bisedime joformale të nivelit të lartë, lidhshipi i saj i ka dhënë shkelmin provincës së mëherëshme dhe ka insistuar në kushte vazhdimisht të ndryshueshme dhe poshtëruese. Ajo ka dështuar në artikullimin e synimeve realiste nga frika se do të dobësonte pozitën e saj taktike në GJND dhe se do të alarmonte opinionin publik. Si pasojë, komuniteti ndërkombëtar dyshon në qëllimet e Beogradit dhe është i prirur t'i shohë propozimet e tij si manovra të thjeshta taktike.

Në të njejtën kohë miqtë e Kosovës, veçanërisht BE-ja, kanë dështuar të barazojnë mbështetjen për pavarësinë e saj me vullnetin politik për të siguruar sovranitet të njohur universalisht dhe integritet të plotë territorial. Ndarja etnike e Mitrovicës është përforcuar nën mbrojtjen e OKB-së dhe BE-së, refugjatët nuk janë lejuar të kthehen dhe BE-ja shpesh ka vendosur t'i nënshtrohet dëshirave të Serbisë. Serbët e Veriut mësuan se dhuna dhe frikësimi shpërblehen. Ndalesa ndaj ndryshimeve të kufijve që komuniteti ndërkombëtar i ka imponuar shtetit të ri, dikur një mbrojtje e vlefshme kundër presionit serb për ndarje,

²¹⁰ NATO kishte bërë publike qëllimin e saj për reduktimin e mëtejme në maj, 2010. Gjatë një vizite në Kosovë, Sekretari i Përgjithshëm, gjenerali Anders Fogh Rasmussen kishte thënë se KFOR-i kishte reduktuar kontigjentin e saj në janar, nga 15,000 në 10,000 dhe se qëllimi i rradhës është që ky numër të bie në 2,000 me krijimin e kushteve të mira të sigurisë. Raporti i Këshillit të Sigurimit, Kosovë, gusht, 2010 (online). "KFOR-i vonon planet e reduktimit", SETimes.com, 11 qershor, 2010 (online).

²¹¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i serbëve të Kosovës, Leposaviq, 1 korrik, 2010.

²¹² Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë serbë, Kosovë Veriore, qershor/korrik, 2010.

²¹³ B. Bojic, "Opasnost od napada Albanskih ekstremista na severu Kosova" [Rreziku nga sulmi i ekstremistëve shqiptarë në veriu e Kosovës], *Press*, 2 gusht, 2010.

ka mbrojtur sovranitetin e Kosovës në Veri vetëm në letër, ndërkohë që është bërë një pengesë ndaj rrafrimit të Kosovës dhe Serbisë në baza të barazisë. Nuk ka ndonjë shenjë që kjo dinamikë do të ndryshojë ose që serbët e Veriut do të jenë më shumë të hapur ndaj Prishtinës në dhjetë apo njëzet vitet e ardhshme.

Pa marrë parasysh rethanat, anëtarët e BE-së, së bashku me SHBA-në duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të bindur shtetet që ta njohin Kosovën, dhe ato shumë shtete që po prisnin opinionin e GJND-së duhet të marrin vendimin pa vonesë. Por tani, më vonë, apo shumë më vonë, nuk ka alternativë tjetër përveç një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse midis Serbisë dhe Kosovës nëse cilido prej shteteve është e interesuar për të ardhmen e tyre në institucionet evropiane. Për Kosovën dhe rajonin, më e mira do të ishte që një marrëveshje të arrihej pa ndryshime të kufijve. Por Akti Final i Helsinkit i vitit 1975 lejon ndryshime të tilla paqësore midis shteteve vetëm nëse janë të pranuar në mënyrë të ndërsjellë nga entitete të barabarta. Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe mirëkuptimi i dyanshëm është më me rëndësi se ruajtja e kufijve. Politika më e mirë për miqtë e Kosovës është të lehtësojnë një mundësi ku të dy palët do të futeshin në dialog të dëlirë dhe të hapur që mund të çojë në marrëveshjen më të plotë në momentin ku jemi, pa koercion dhe pa agjenda të imponuara apo të kufizuara nga jashtë.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 26 gusht, 2010

ANEKSI A

HARTA E KOSOVËS DHE RRETHINAT



ANEKSI B

FJALORTHI

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca për Kosovën e Re
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore e Lindore
CSP	Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës
PD	Partia Demokratike
PDS	Partia Demokratike e Serbisë
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Sundimit të Ligjit i BE-së
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
TNKJ	Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forca e NATO-s në Kosovë
PK	Policia e Kosovës
LDD	Lidhja Demokratike e Dardanisë
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MTS	Telefonia Mobile e Serbisë
MUP	Ministria (serbe) e Punëve të Brendshme
NATO	Organizata e Traktatit Veriatlantik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
RS	Republika Srpska
SLS	Partia Liberale e Pavarur
SNS	Partia Progresive Serbe
SRS	Partia Radikale Serbe
UCPMB	Ushtria Clirimtare e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit
KB	Kombet e Bashkuara
APKB	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar.